

Praktikat e 15 komunave në shpërndarjen e investimeve kapitale nëpër lokalitete 2018–2023



Shkurt 2025



Co-funded by
the European Union



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



Sweden
Sverige

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC

Praktikat e 15 komunave në
 shpërndarjen e investimeve
 kapitale nëpër lokalitete
 2018–2023
 (Analizë në 15 komuna të Kosovës)

Shkurt 2025

— Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
Hyrje	4
Metodologjia	5
1. Buxheti për investime kapitale gjatë periudhës 2018 – 2023	5
2. Shpërndarja e buxhetit për investime kapitale për periudhën 2018 – 2023 sipas lokaliteteve dhe fushave	7
2.1 Komuna e Dragashit	8
2.2 Komuna e Drenasit	11
2.3 Komuna e Kaçanikut	14
2.4 Komuna e Podujevës	16
2.5 Komuna e Prizrenit	19
2.6 Komuna e Rahovecit	23
2.7 Komuna e Ferizajt	25
2.8 Komuna e Klinës	28
2.9 Komuna e Kamenicës	31
2.10 Komuna e Obiliqit	33
2.11 Komuna e Pejës	35
2.12 Komuna e Suharekës	38
2.13 Komuna e Vitisë	41
2.14 Komuna e Junikut	44
2.15 Komuna e Graçanicës	45
3. Sa përfshihen në buxhetin e investimeve kapitale lokalitetet e banuara nga komunitetet jo shumicë	47
4. Ndërlidhja e investimeve kapitale me premtimet elektorale	48
5. Buxheti i përgjegjshëm gjinor në 15 komuna	50
6. Procesi i konsultimit me qytetarë në fazën e hartimit të buxhetit (2018 – 2023)	51
Përfundime dhe rekomandime	54

Deklaratë mohimi:

Ky publikim është bashkëfinancuar nga Bashkimi Evropian, Zvicra dhe Suedia përmes projektit DEMOS, zbatuar nga Helvetas Swiss Intercooperation. Përmbajtja e tij është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Helvetas Swiss Intercooperation, Bashkimit Evropian, Zvicrës dhe Suedisë.

©DEMOS Publikuar: Shkurt 2025, Prishtinë, Kosovë

Përmbledhje ekzekutive

Investimet kapitale në 15 komuna të Kosovës gjatë periudhës 2018–2023 kanë pasur rritje të përgjithshme të buxheteve, me një rritje prej 40% nga viti 2018 në vitin 2023. Megjithatë, viti 2020 dhe 2021 shënoi një rënie të buxhetit në shumicën e komunave, rreth 15%, kryesisht për shkak të ndikimit të pandemisë COVID-19. Pastaj, periudha 2022–2023 u karakterizua nga një rimëkëmbje e ndjeshme, me disa komuna që tejkaluan nivelet e rritjes para pandemisë.

Shpërndarja e investimeve kapitale sipas fushave tregon një fokus të madh të investimeve në infrastrukturë, e cila mori mesatarisht 65% të buxhetit kapital në 15 komunat. Arsimi, zakonisht fusha e dytë për nga investimet, mori 10–15% të buxhetit të kapitaleve, por me luhatje të mëdha ndër vite. Shëndetësia pati një rritje të ndjeshme në 2020, me disa komuna që dyfishuan investimet në këtë sektor, por pasuar me një rënie graduale të buxhetit për këtë sektor në vitet vijuese. Kultura dhe bujqësia morën më pak buxhet si sektorë, shpesh nën 5% të buxhetit total për kapitale.

Nga 15 komunat e analizuar në këtë raport, Kamenica kishte rritjen më të madhe të buxhetit në kapitale në periudhën 2018–2023, ku nga 124 mijë euro në vitin 2018, buxheti i saj arriti në 2.2 milionë euro në vitin 2023. Në anën tjetër, Graçanica dhe Juniku ishin të vetmet që kishin rënie buxhetore në po të njejtën periudhë. Prizreni ishte në krye, si komuna me buxhetin më të lartë në kapitale, me rreth 185 milionë euro për gjashtë vite, pasuar nga Ferizaj me rreth 70 milionë euro.

Në periudhën 2018–2023, investimet kapitale në 13 komuna të Kosovës, përjashtuar Junikun dhe Graçanicën, për shkak se këto dy komuna nuk i kanë paraqitur të dhënat e detajuara të shpenzimit të buxhetit sipas lokaliteteve, arritën vlerën totale prej 540 milionë euro, prej të cilave 98 milionë euro ose 18% u investuan në zona rurale kurse 442 milionë ose 82% në zonat/lagjet e qytetit.

Shpërndarja e fondeve nëpër lokalitete rurale tregon pabarazi të dukshme. Në disa komuna, lokalitete të caktuara kanë përfituar shuma të larta, ndërsa të tjera kanë përfituar pak ose asnjë investim. Përjashtuar Junikun dhe Graçanicën që në buxhetet e tyre nuk i specifikojnë se cilat lokalitete përfitojnë, 13 komunat e tjera kanë gjithsej 595 lokalitete. Nga këto, 166 lokalitete (28%) nuk kanë përfituar fare nga investimet kapitale, 193 lokalitete (32.5%) kanë përfituar pjesërisht (në së paku tri nga gjashtë vitet), ndërsa 236 lokalitete (39.5%) kanë përfituar çdo vit ose së paku pesë në gjashtë vite përgjatë periudhës 2018 – 2023.

Komuna me numrin më të madh të lokaliteteve është Prizreni me 83, ndërsa Obiliqi ka numrin më të vogël me vetëm 19. Disa komuna si Kamenica, Obiliqi, Peja dhe Vitia nuk kanë asnjë lokalitet që ka përfituar çdo vit nga investimet kapitale. Prizreni, me 83 lokalitete gjithsej, ka numrin më të lartë të lokaliteteve që kanë përfituar pjesërisht (41) dhe një numër të konsiderueshëm që kanë përfituar çdo vit (34). Peja ka një ndarje të barabartë mes lokaliteteve që nuk kanë përfituar dhe atyre që kanë përfituar pjesërisht (34 secila). Ndërkohë, Suhareka ka një kontrast të theksuar, ku asnjë lokalitet nuk ka mbetur pa përfituar, dhe shumica e lokaliteteve (87.2%) kanë përfituar çdo vit gjatë periudhës 2018 -2023.

Nga hulumtimi i zhvilluar, del se shumica e lokaliteteve ku jetojnë komunitetet jo shumicë, me përjashtim të Dragashit dhe Prizrenit, përfitojnë pak ose aspak nga kategoria e buxhetit që i përket investimeve kapitale.

Pavarësisht se pjesa më e madhe e buxhetit për investime kapitale shpenzohet në infrastrukturë, shumë komuna po hasin vështirësi në përmbushjen e premtimeve elektorale të dhëna në këtë fushë. Kjo tregon një mospërputhje midis planifikimit (premtimeve) dhe realizimit të projekteve. Po ashtu, raporti gjen se zgjedhja e kryetarëve të rinjë në disa komuna, nuk tregon për ndonjë ndryshim thelbësor në shpërndarjen e buxhetit nëpër lokalitete.

Për më shumë, procesi i konsultimit publik të qytetarëve nga ana e komunave vazhdon të shoqërohet me përfaqësim të vogël të qytetarëve. Gjatë vitit 2023, në 11 komuna janë organizuar 97 takime dhe konsultime buxhetore me pjesëmarrjen e rreth 2,200 qytetarëve. Si rezultat, nga 1,385 kërkesa të paraqitura nga qytetarët, 756 (55%) u morën parasysh nga komunat gjatë procesit të hartimit të buxhetit për vitin pasues.

Hyrje

Buxheti i komunës është dokumenti themelor përmes të cilit komuna parasheh realizimin e planeve të saj. Përmes buxhetit, komuna pasqyron mbështetjen për sektorët kyç si dhe demonstroi orientimin e saj se çfarë mbështetje do t'u japë çështjeve që mund t'i përkasin fushave të ndryshme si: infrastruktura, shëndetësia, arsimiti, rinia, bujqësia, mjedisi, çështjet sociale, apo edhe ngritja e burimeve njerëzore.

Duke u nisur nga kjo, udhëheqësia e komunës duhet të sigurohet se buxheti është hartuar bazuar në disa parime themelore, fillimisht buxheti duhet t'i reflektojë planet e komunës, që përfshijnë planet rregulluese, hartat zonale, strategjitë nacionale apo sektoriale etj. Po ashtu, buxheti duhet të ketë gjithëpërfshirje gjatë fazës së hartimit, që garanton konsultim me qytetarët, bizneset dhe subjektet e tjera brenda dhe jashtë komunës. Buxheti njëherazi duhet të garantojë që nuk përmban elemente të diskriminimit gjinor, etnik, politik apo të çfarëdo lloji diskriminimi e përjashtimi tjetër. Hartimi i buxhetit duhet të ketë orientim zhvillimor për komunën dhe, jo më pak e rëndësishme, përmbajtja e buxhetit duhet të jetë e detajuar, e qartë dhe e plotë, për të shmangur paqartësi dhe dykuptimësi.

Ky raport i hartuar nga Instituti GAP me mbështetjen e projektit DEMOS:

1. Analizon potencialin dhe trendet e komunave në përdorimin e buxhetit për investimet kapitale.
2. Pasqyron mënyrën se si shpërndahet ky buxhet i komunave sipas lokaliteteve, duke identifikuar lokalitetet që përfitojnë më shumë dhe më shpesh nga fondet publike dhe ato që marrin më pak mbështetje ose nuk përfitojnë fare investime kapitale.
3. Shqyrton nëse ekziston një lidhje në mes investimeve kapitale dhe premtimeve elektorale.
4. Raporti tregon për shumatat e mjeteve financiare që kanë ndarë 15 komunat në lokalitetet e banuara nga komunitetet jo shumicë.
5. Ofron të dhëna lidhur me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor në 15 komunat e fokusuar.
6. Raporti shpërfaq ecurinë e konsultimeve buxhetore të këtyre komunave, me theks të veçantë gjatë vitit 2023, dhe tregon për numrin e pjesëmarrësve, kërkesat e paraqitura, dhe se sa prej kërkesave janë marrë për bazë gjatë hartimit (miratimit) të buxhetit.

Metodologjia


Ky raport fokusohet në 15 komuna të Kosovës: Drenas, Kaçanik, Pejë, Kamenicë, Obiliq, Graçanicë, Suharekë, Rahovec, Klinë, Viti, Dragash, Junik, Ferizaj, Podujevë dhe Prizren. Bazuar në të dhënat e regjistrimit të popullsisë së vitit 2011, në këto komuna jetojnë 867,417 banorë apo 50% e popullatës së përgjithshme të Kosovës. Për t'u përgjigjur në çështjet më lartë, raporti bazohet në të dhëna të ndryshme. Përfshi këtu ndarjet buxhetore të komunave të Kosovës për investime kapitale për vitet 2018, 2019, 2020, 2021, 2022 dhe 2023 të cilat janë analizuar dhe ndarë sipas projekteve, lokaliteteve dhe shumave që janë dedikuar. Pastaj, janë marrë të dhënat e ndara sipas fushave ku janë dedikuar buxhetet kapitale si infrastrukturë, arsim, kulturë, bujqësi ose shëndetësi. Githashtu janë analizuar edhe ndarjet buxhetore sipas kategorisë së kapitaleve dhe trendit të tyre nga viti 2018 – 2023 sipas komunave dhe krahasuar mes komunave. Dhe, po ashtu, raporti bazohet edhe në të dhëna tjera si numri i premtimeve elektorale për zgjedhjet lokale për mandatet 2013–2017, 2017–2021 dhe 2021–2025. Njëherazi, ky raport përdorë edhe të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, sikurse për numrin e popullsisë për vitin 2011, si dhe të dhënat lidhur me buxhetimin e përgjegjshëm gjinor që publikohen ose jo sipas komunave përkatëse. Raporti është hartuar edhe bazuar në të dhënat e konsultimeve publike të zhvilluara nga këto komuna gjatë periudhës së vitit 2023. Përveç procesverbaleve, janë analizuar edhe raportet e konsultimeve publike, raportet e veçanta nga terreni, dhe në fund janë krahasur të dhënat e buxhetit të komunës me kërkesat e parashtruara nga qytetarët.

1. Buxheti për investime kapitale gjatë periudhës 2018 – 2023

Nga të dhënat buxhetore për periudhën 2018–2023, 15 komunat e përfshira në këtë raport (Drenasi, Kaçaniku, Peja, Kamenica, Obiliqi, Graçanica, Suhareka, Rahoveci, Klinë, Viti, Dragashi, Juniku, Ferizaji, Podujeva dhe Prizreni) së bashku kanë pasur në dispozicion 566 milionë euro për investime kapitale. Në vitin 2019, buxheti për investime kapitale për këto komuna arriti në 107 milionë euro, për të vazhduar pastaj me një rënie të vazhdueshme nga 2020 deri në 2022, ulje që u ndikuan për shkak të pandemisë COVID-19 dhe ridestinitimit të mjeteve nga investimet kapitale në kategoritë e tjera me qëllim të mbulimit të shpenzimeve që kërkonin masat e ndërmarra në frenimin dhe menaxhimin e pandemisë. Pandemia ka ndikuar në dy rrafshë, atë publik dhe privat. Në sektorin publik, ndikimi ka qenë në kufizimin e mundësisë për investime publike, në ofrimin e kufizuar të shërbimeve publike dhe administrative, pamundësinë e komunave në ndërmarrjen e procedurave të prokurimit publik, anulimin e takimeve të organeve kolektive komunale si mbledhjet e Kuvendit dhe të komiteteve, si dhe anulimin e konsultimeve publike. Ndërsa, në sektorin privat, më të prekur kanë qenë sektori i ndërtimitarisë, hotelarisë dhe gastronomisë.¹ Për shkak të kësaj situatë, komunat kanë rishikuar prioritetet e tyre, duke kufizuar shpenzimet në fusha jo-kapitale për të mbështetur sektorët më të prekur, si shëndetësia dhe ndihma ekonomike për bizneset dhe individët. Por periudha pas pandemike, përkatësisht në vitin 2023, buxheti për investime kapitale shënoi një rritje me gjithsej 120 milionë euro, rritje kjo që ka ardhur kryesisht nga grantet qeveritare, por rritje kanë pasur edhe të hyrat vetanake.

Konkretisht, granti i përgjithshëm është rritur nga 179 milionë në vitin 2018 në 255 milionë në 2023, që paraqet një rritje prej afërsisht 42%. Po ashtu, në grantin e arsimit, është hasur rritje e konsiderueshme në vitin 2021 në 206 milionë, por pastaj një rënie e lehtë në 201 milionë në 2023. Megjithatë, krahasuar me vitin 2018, paraqet një rritje prej rreth 19%. Ndërkaq, granti për shëndetësi tregon trendin më konsistent të rritjes, duke u rritur nga 48 milionë në 2018 në 70 milionë në 2023, që përbën një rritje prej 46%. Të hyrat vetanake kanë pasur luhajtje, nga 81 milionë në 2018, ato arritën në 98 milionë në 2023, që paraqet një rritje prej 21%. Por pavarësisht kësaj rritjeje, raporti i të hyrave të komunave mbetet me 84% të hyra nga grantet qeveritare dhe 16% nga të hyrat vetanake.


¹ Instituti GAP. Raport, Ndikimi i pandemisë COVID-19 në pushtetin lokal. Fq 4 & 5. Maj 2020.

Figura 1. Shuma totale e buxhetit për investime kapitale në 15 komuna gjatë periudhës 2018 – 2023

Burimi: Ligjet për ndarjet buxhetore të viteve përkatëse të paraqitura në tabelë të publikuara në gazetën zyrtare.

Komuna që ka shënuar rritjen më të madhe buxhetore në kapitale gjatë kësaj periudhe është Kamenica, e cila kishte një buxhet prej rreth 125 mijë euro në vitin 2018 dhe rreth 2.2 milionë euro në vitin 2023. Rritja e buxhetit të Kamenicës ka ardhur për shkak të rritjes së buxhetit në grantin e shëndetësisë. Ky grant për këtë komunë në vitin 2019 ka qenë afro 1.1 milionë euro, përderisa në vitin 2023 është vlerësuar në 2.6 milionë euro. Në anën tjetër, Graçanica dhe Juniku janë dy komunat e vetme mes 15 komunave të analizuara që kanë shënuar një rënie të buxhetit gjatë kësaj periudhe. Graçanica ka pësuar një rënie prej 16.8%, ndërsa Juniku 11% nga viti 2018 deri në vitin 2023. Rënia të Graçanica ka ardhur për shkak se komuna ka vendosur të rrisë buxhetin në mallra dhe shërbime dhe të ulë atë në kapitale, përkatësisht në këtë komunë në vitin 2018 shuma e mjeteve për mallra dhe shërbime ka qenë 720 mijë euro, ndërsa në 2023 kjo shumë ka arritur në afro 1.8 milionë euro. Përderisa, te Juniku arsyeja e rënies së buxhetit është ulja nga financimi i grantit të përgjithshëm. Përkatësisht, përderisa në vitin 2019 nga ky grant kjo komunë ka marrë afro 1.1 milionë euro, në vitin 2023 kjo shumë ka qenë 783 mijë euro. Komunat me shumën më të vogël të buxhetit në kapitale për gjashtë vite janë Juniku me 1.7 milionë, Kamenica me 6.8 milionë dhe Kaçaniku me 13 milionë euro.

Në mesin e këtyre 15 komunave, Prizreni ka pasur buxhetin më të lartë për investime kapitale gjatë këtyre gjashtë viteve, me gjithsej rreth 185 milionë euro. Pas tij renditet Ferizaj, me një vlerë prej afro 70 milionë euro, duke lënë pas Pejën, e cila ka pasur 18 milionë euro më pak.

Figura 2. Shuma totale e buxhetit për investime kapitale në 15 komuna ndarë sipas komunave dhe viteve

Burimi: Ligjet për ndarjet buxhetore të viteve përkatëse të paraqitura në tabelë të publikuara në gazetën zyrtare.

2. Shpërndarja e buxhetit për investime kapitale për periudhën 2018 – 2023 sipas lokaliteteve dhe fushave

Nga 15 komunat e përfshira në këtë raport, 13 prej tyre kanë paraqitur të dhënat në buxhetet e tyre se si i kanë shpërndarë investimet kapitale bazuar në lokalitete. Ka raste si Kamenica dhe Vitia që këto të dhëna i kanë paraqitur vetëm në vitin e fundit 2023, por jo edhe për vitet paraprake, ndërsa Graçanica dhe Juniku vazhdojnë t'i paraqesin investimet kapitale pa specifikuar lokalitetet se ku do të shpërndahen fondet. Fondet këto dy komuna i paraqesin vetëm bazuar në projekte, jo edhe ndarë sipas lokaliteteve. Kjo ndodhë edhe përkundër që në qarkoren e parë buxhetore që pranojnë këto komuna nga Ministria e Financave u kërkohet që hartimi i buxhetit duhet të paraqitet i detajuar, përfshirë edhe ndarjen sipas lokaliteteve. Në 13 komuna janë përfshirë 595 lokalitete. Gjatë vitit 2018 – 2023 është konstatuar se 154 lokalitete (26%) nuk janë përfshirë asnjë vit gjatë këtyre gjashtë viteve në ndarjet buxhetore, 203 lokalitete (34%) janë përfshirë pjesërisht, çka nënkupton se kanë përfituar fonde në së paku tri vite nga gjashtë vite, dhe 237 lokalitete (40%) kanë përfituar fonde për çdo vit ose së paku në pesë nga gjashtë vitet e fokusuar në këtë raport.

Tabela 1. Shuma e mjeteve për investime kapitale për gjashtë vite sipas komunave dhe shuma dhe përqindja që kanë përfituar zonat rurale dhe ato urbane

Komunat	Shuma totale për investime kapitale 2018–2023	Investimet në zona rurale	Investimet në zona urbane	% Rurale	% Urbane
Ferizaj	69,597,402	14,962,904	54,634,498	22%	78%
Pejë	52,332,311	11,500,000	40,832,311	22%	78%
Obiliq	28,618,902	2,110,242	26,508,660	8%	92%
Suharekë	29,351,789	10,705,324	18,646,465	37%	63%
Kamenicë	6,812,857	1,595,400	5,217,457	24%	76%
Rahovec	26,304,682	4,305,457	21,999,225	17%	83%
Klinë	17,656,919	5,547,000	12,109,919	31%	69%
Viti	15,168,458	3,916,979	11,251,479	26%	74%
Podujevë	50,874,242	11,657,603	39,216,639	23%	77%
Prizren	185,958,888	11,657,603	174,301,285	6%	94%
Kaçanik	12,781,484	2,565,000	10,216,484	20%	80%
Drenas	27,723,653	9,784,763	17,938,890	35%	65%
Dragash	16,670,193	8,284,659	8,385,534	50%	50%
Totali	540,631,778	98,277,534	442,354,244	18.2%	81.8%

Në periudhën 2018–2023, investimet kapitale në 13 komuna të Kosovës arritën vlerën totale prej 540 milionë euro, prej të cilave 98 milionë euro ose 18% u investuan në zona rurale ndërsa 442 milionë ose 82% në zonat/lagjet e qytetit.


Prizreni prin listën me investime kapitale prej 185 milionë euro, që përfaqëson 34% të investimeve totale të të gjitha komunave të analizuar. Megjithatë, vetëm 6.3% e këtyre investimeve në Prizren u dedikuan për zona rurale. Ferizaj është komuna e dytë për nga volumi i investimeve me afro 70 milionë euro, ku 21% e këtyre investimeve u realizuan në zona rurale. Peja renditet e treta me 52 milionë euro investime totale, ku 22% e tyre u dedikuan zonave rurale.

Në aspektin e përqindjes së investimeve në zona rurale, Dragashi prin me 49.7% të investimeve të dedikuara për zonat rurale, pasuar nga Suhareka me 36.5% dhe Drenasi me 35.3%. Obiliqi ka përqindjen më të ulët të investimeve në zona rurale me vetëm 7.4% të buxhetit total. Kjo komunë (Obiliqi) ka nisur të specifikoj ndarjen e buxhetit për lokalitete vetëm në vitet e fundit të këtij vlerësimi.

2.1 Komuna e Dragashit


Gjatë periudhës 2018–2023, Komuna e Dragashit ka pasur një mesatare prej 2.7 milionë euro për investime kapitale në vit, me gjithsej 16 milionë euro. Pas një periudhe me ndryshime, me një rënie nga viti 2019 deri 2021, buxheti për këtë kategori ka pasur një rritje prej vitit 2022, duke arritur nivelin më të lartë prej 3.9 milionë euro në vitin 2023.

Figura 3. Buxheti për investime kapitale në Dragash 2018 – 2023



Burimi: Buxheti i Komunës së Dragashit sipas viteve të paraqitura në tabelë

Figura 4. Shpërndarja e buxhetit sipas fushave kryesore në Komunën e Dragashit përgjatë viteve 2018 – 2023



Burimi: Buxheti i Komunës së Dragashit sipas viteve të paraqitura në tabelë. Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumatat kryesore të financiare nga ana e kësaj komune.

Infrastruktura ka qenë prioriteti kryesor gjatë kësaj periudhe, me një rritje të investimeve prej 48%, nga 2 milionë euro në 2018 në 3 milionë euro në 2023. Arsime ka pasur një trend relativisht të qëndrueshëm, me një rritje të lehtë prej 25%, nga 235 mijë euro në 2018 në 293 mijë euro në 2023. Megjithatë, viti 2021 shënoi një rënie të përkohshme në financimin e arsimit.

Shëndetësia ka përjetuar rritjen më të madhe proporcionale, duke u rritur nga 103 mijë euro në 2018 në 333 mijë euro në 2023, një rritje prej 223%. Kjo tregon një ndryshim të rëndësishëm në prioritetet, veçanërisht pas vitit 2020, si përgjigje ndaj sfidave shëndetësore që lidhen me përhapjen e pandemisë COVID-19.

Kultura ka pasur lëvizjet më të mëdha. Nga 140 mijë euro në 2018, buxheti ra ndjeshëm në 10 mijë euro në vitet 2021 dhe 2022, por u rikthye në 2023 me 191 mijë euro duke shënuar një rritje të përgjithshme prej 37% krahasuar me 2018.

Tabela 2. Shpërndarja e Investimeve kapitale në Dragash sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018 – 2023, në euro

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Restelicë	205,000	216,486	269,500	236,000	246,000	60,000	1,232,986
Leshtan	40,000	15,000	9,000	25,000	25,000	543,000	657,000
Krushevc	115,000	55,430	130,000	70,000	90,000	152,000	612,430
Brense				195,000	55,000	260,078	510,078
Brod	90,000	70,427	63,000	85,000	85,000	105,000	498,427
Zlipotok	45,000	70,000	103,500	51,300	131,000	67,000	467,800
Radeshë	60,000	30,000	40,500	50,000	50,000	230,000	460,500
Bellobrod	35,000	50,000	50,000	90,000	90,000	78,572	393,572
Glloboçica	30,000	40,000	18,000	40,000	40,000	203,044	371,044
Zgatar	20,000		95,000	49,661	49,661	95,000	309,322
Shajinë	40,000	50,000	67,000	15,000	70,000	60,000	302,000
Kukulan	85,000	55,000		90,000	69,000		299,000
Kuklibreg	20,000	30,000	30,000	60,000	60,000	50,000	250,000
Kapre	15,000	45,000	15,000	50,000	50,000	65,000	240,000
Rrencë	30,000		30,000	60,000	60,000	60,000	240,000
Buçe	20,000	30,000	35,000	20,000	60,000	50,000	215,000
Pllajnik	15,000	25,000	30,000	20,000	20,000	95,000	205,000
Baçkë		15,000	13,500	15,000	95,000	20,000	158,500
Xërxe	15,000	15,000	20,000	20,000	20,000	60,000	150,000
Lubovishtë	15,000	20,000	18,000	35,000	20,000	30,000	138,000
Mlikë	20,000	20,000	18,000	20,000	20,000	30,000	128,000
Buzez	10,000	10,000	15,000	30,000	30,000	30,000	125,000
Pllav	35,000		8,000	20,000	20,000	40,000	123,000
Dikancë	10,000	15,000	9,000	15,000	15,000	25,000	89,000
Orqushë	10,000		9,000	10,000	10,000	20,000	59,000
Kërstec				25,000	25,000		50,000
Gjithsej							8,284,659

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbrasura nënkuptojnë se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet. Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Komuna e Dragashit, gjatë periudhës nga viti 2018 deri në fund të vitit 2023 ka pasur në dispozicion për investime kapitale shumë mbi 16 milionë euro, nga të cilat 8.2 milionë euro apo 49.7% janë investuar në lokalitetet rurale dhe 8.3 milionë euro apo 50.3% në lagjet e qytetit. Kjo ndarje tregon një shpërndarje pothuajse të barabartë të investimeve mes zonave rurale dhe urbane, me një diferencë të vogël prej vetëm 0.6 pikë përqindje në favor të zonave urbane.

Nga gjithsej 30 lokalitete rurale në Dragash, katër prej tyre apo 13% nuk kanë përfituar fare nga investimet kapitale, tri lokalitete apo 10% kanë përfituar pjesërisht, dhe pjesa më e madhe, 23 lokalitete apo 77% kanë përfituar vazhdimisht nga këto investime.

Restelica del si përfituesja më e madhe me një total prej 1.2 milionë euro, që tregon një investim të konsiderueshëm në këtë lokalitet. Pasohet nga Leshtani me 657 mijë euro dhe Krusheva me 612 mijë euro. Këto tri lokalitete duket se kanë qenë në fokus të zhvillimit komunal, duke marrë pjesën më të madhe të buxhetit.

Në anën tjetër, lokalitete si Vranishtë, Blas, Brodosanë dhe Brut nuk kanë marrë asnjë fond gjatë kësaj periudhe.

Disa lokalitete si Kërsteci dhe Orqusha kanë marrë fonde relativisht të vogla, përkatësisht 50 mijë euro dhe 59 mijë euro. Po ashtu vihet në pah se disa lokalitete si Brensa kanë filluar të marrin fonde vetëm në vitet e fundit, me një total prej gjysëm milioni euro, çka mund të tregojë një ndryshim në prioritetet e komunës ose nisjen e projekteve të reja në këto zona me pak të përfshira në periudhat e mëhershme.

Procesi i shtrirjes së konsultimeve publike me qytetarë në Dragash për buxhetin e komunës, referuar vitit 2023, nxjerrë në pah se janë organizuar 8 dëgjime dhe ku janë regjistruar 201 pjesëmarrës. Rreth 78% e propozimeve që janë parashtruar nga qytetarët janë përfshirë në buxhet nga komuna, gjë e cila e bën këtë komunë të dytën pas Drenasit për shkallën e përfshirjes së kërkesave të qytetarëve në buxhet.

Kërkesat që përgjithësisht janë marrë parasysh kanë qenë rregullimi i rrugëve, trotuarëve, riparimi i objekteve publike, ndërtimi i fushave sportive si dhe instalimi i ndriçimit publik. Disa nga kërkesat e pranuar janë: ndërtimi i një rruge dytësore në fshatin Brod, rregullimi i kanalizimit në fshatin Bellobrad, kërkesa për zgjerimin e ndriçimit publik në Restelicë, kërkesa për rregullimin e ujësjellësit në fshatin Krushevë, futja në menaxhim të mirëmbajtjes së rrugëve në Rapçë, riparimi i shkollës në Zlipotok dhe rregullimi i hapësirave të gjelbërta në Lubovishtë.


Ndërsa në mesin e kërkesave të refuzuara janë: asfaltimi i një rruge private, kërkesa për ndërtimin e një objekti pa leje, kërkesa për ndërtimin e objektit në zonë të mbrojtur në Bellobrad, kërkesa për ndryshimin e destinimit të tokës bujqësore në Rapçë, kërkesa për vendosjen e antenës së telefonisë mobile në Bresan, dhe kërkesa për ndërtimin e objektit në pronë publike – në Glloboçicë. Arsyeja e refuzimit të këtyre kërkesave ka ardhur për shkak se natyra e kërkesave të parashtruara ka pasur të bëjë me vendime ku komuna do ta shkelte ligjin nëse do të vendoste në favor të kërkesave, ngase komuna e ka obligim t'i mbrojtë zonat e mbrojtura, të mos lejojë ndërtime pa leje dhe po ashtu nuk e ka për obligim ligjor të asfaltojë ose investojë në rrugë private.

Projektet më të kushtueshme infrastrukturore në Komunën e Dragashit gjatë periudhës 2018-2023 janë: ndërtimi i rrugës Dragash-Brod, ndërtimi i sistemit të kanalizimit për 15 fshatra (projekt akoma jo krejtësisht i finalizuar) si dhe renovimi i qendrës së qytetit që përfshin rregullimin e sheshit kryesor, ndriçimin publik dhe infrastrukturën përcjellëse.

2.2 Komuna e Drenasit


Gjatë periudhës 2018–2023, gjithsej buxheti për investime kapitale në Drenas ka arritur shumën prej 27.7 milionë euro. Kjo kategori ka treguar luhatje të theksuara, veçmas gjatë periudhës 2020 dhe 2022 që mund të jenë ndikuar nga faktorë si pandemia dhe efektet negative që komuna ka pasur në grumbullimin e buxhetit, sidomos në të hyrat vetanake. Megjithatë, në vitin 2023 kjo kategori ka shënuar një rritje të ndjeshme, duke u rritur me 34% krahasuar me vitin 2018.

Figura 5. Buxheti për investime kapitale në Drenas 2018 – 2023



Gjatë periudhës 2018–2023, investimet kapitale janë përqendruar kryesisht në infrastrukturën rrugore, e cila ka marrë shumicën e fondeve me një total prej mbi 18 milionë euro duke përfaqësuar rreth 80% të alokimit total të buxhetit në kapitale. Kjo ndarje tregon, një rritje prej 51% nga viti 2018 në vitin 2023, duke kulmuar në afro 4.3 milionë euro në vitin 2023.

Figura 6. Shpërndarja e buxhetit sipas fushave kryesore në Komunën e Drenasit përgjatë viteve 2018 – 2023



Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiarë nga ana e kësaj komune.

Arsimi ka përfituar gjithsej 2 milionë euro gjatë kësaj periudhe, me investimin më të lartë prej 498 mijë euro në vitin 2019, ndërsa në vitin 2023 investimet ranë në 362 mijë euro, një rënie prej 27% nga niveli më i lartë. Kjo tregon një fokus më të kufizuar për arsimin krahasuar me infrastrukturën rrugore, me një luhatje të investimeve ndër vite ose edhe zhvendosje të prioriteteve.

Kultura, me një total investimesh prej 1.8 milionë euro ka parë shuma më të ulëta dhe luhatje ndër vite. Investimi më i lartë është bërë në vitin 2022 me 377 mijë euro ndërsa më i ulëti

në vitin 2020 me 215 mijë euro. Kjo e bënë këtë fushë një prioritet më të ulët krahasuar me sektorët e tjerë.

Shëndetësia ka përfituar një total prej 2.1 milionë euro me një rritje të ndjeshme prej 151% nga 205 mijë euro në vitin 2018 në 515 mijë euro në vitin 2023. Ky sektor tregon një prirje në rritje të investimeve, të ardhura këto edhe nga specifikat shëndetësore që ka pasur vendi gjatë periudhës 2020 dhe 2021.

Tabela 3. Shpërndarja e investimeve kapitale në Drenasit sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018- 2023

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Komoran	205,000	290,000	90,000	110,000	110,000	778,000	1,583,000
Baicë	137,000	160,000	260,000	60,000	60,000	30,000	707,000
Dobroshec	41,716	91,515		60,000		515,000	708,231
Tërstenik	82,000	190,683	155,000	70,000		125,000	622,683
Abri e Epërme		170,000	180,000	60,000	60,000	80,000	550,000
Llapushnik	140,000	121,596	55,000	60,000		150,000	526,596
Vasilevë				50,000		455,000	505,000
Kishnarekë	60,000	120,000	90,000	60,000	60,000	80,000	470,000
Gllanasellë	45,000	80,000	68,520	60,000	60,000	110,000	423,520
Gradicë	20,000	117,000	70,000	60,000	60,000	80,000	407,000
Fushticë e Poshtme	45,000	70,000	65,000	40,000	40,000	80,000	340,000
Negroc	70,000	60,000	90,000			80,000	300,000
Shtuticë	89,000	100,000	75,000			10,000	274,000
Poklek i Vjetër	30,000	100,000	60,000			70,000	260,000
Poluzhë	25,000			58,881	56,881	80,000	220,762
Gllobar	36,732	1,516	9,000	5,000	75,000	80,000	207,248
Koroticë e Poshtme				60,000	60,000	80,000	200,000
Arllat	125,000	20,000					145,000
Poklek i ri	57,000				60,000		117,000
Domanek	20,000					80,000	100,000
Nekoc	70,000	27,674					97,674
Krajkovë	87,000						87,500
Tërdec		40,000	45,000				85,000
Vërboc	85,000						85,000
Likoshan	82,549						82,549
Zabel i Eperm	20,000	60,000					80,000
Bytyq	70,000						70,000
Zabel i Ulët	70,000						70,000
Zabeli i Ultë		60,000					60,000
Vukovc					60,000		60,000

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Gjergjic				60,000			60,000
Çikatovë					60,000		60,000
Godanc	50,000						50,000
Zabeli i Epërm			50,000				50,000
Shtrubullojë	50,000						50,000
Qikatova e Vjetër	45,000						45,000
Qikatovë e Re	20,000						20,000
Vuçak					5,000		5,000
Gjithsej							9,784,763

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbrasura nënkupton se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet. Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Drenasi gjatë periudhës 2018–2023 ka pasur në dispozicion mbi 27 milionë euro për investime kapitale, 9.7 milionë euro (35%) janë investuar në zona rurale dhe afro 18 milionë euro (65%) në zona urbane.

Gjatë periudhës 2018–2023, në komunën e Drenasit vërehet se disa lokalitete kanë përfituar dukshëm më shumë se të tjerat, ndërsa disa nuk kanë marrë asnjë fond gjatë kësaj periudhe. Drenas ka 41 lokalitete rurale, dhe prej tyre 7% (3) nuk kanë përfituar, 15% (6) kanë përfituar pjesërisht, 78% (32) kanë përfituar vazhdimisht ose se paku në pesë nga gjashtë vite.

Komorani del si lokaliteti që ka përfituar më së shumti, me një total prej afro 1.6 milionë euro. Pas Komoranit, Baica dhe Dobrosheci kanë marrë shumat më të larta, përkatësisht 747 mijë euro dhe 708 mijë euro.

Në anën tjetër, disa lokalitete kanë marrë fonde minimale ose asnjë fond. Për shembull, Vuçaku ka marrë vetëm 5,000 euro, ndërsa për Stankocin, Koreticë e Epërme dhe Fushticën e Epërme nuk është hasur në buxhet asnjë fond i alokuar. Kjo diferencë e madhe në shpërndarjen e buxhetit të kapitaleve shtron pyetjen nëse janë marrë parasysh nevojat specifike të secilit lokalitet.

Është e rëndësishme të theksohet se disa lokalitete kanë marrë fonde të konsiderueshme në vitet e fundit, siç është rasti i Vasilevës që ka marrë 455 mijë euro vetëm në vitin 2023, gjë që tregon për një ndryshim të mundshëm në prioritetet e komunës ose për projekte të reja të filluara në këto zona më pak të mbështetura në periudhën e parë të 2018.


Komuna e Drenasit, krahas komunës së Prizrenit dhe asaj të Lipjanit, është komuna që në formë të plotë publikon procesverbalet nga takimet që zhvillon me qytetarë për t'i konsultuar çështjet buxhetore. Gjatë vitit 2023, janë mbajtur tetë konsultime buxhetore me qytetarë ku kanë qenë prezentë 281 pjesëmarrës. Nga vlerësimet e bëra rezulton se nga 92 kërkesa që kanë parashtruar qytetarët, 64 prej tyre janë përfshirë në verzionin e fundit të buxhetit. Kërkesat e pranuar kryesisht kanë qenë të natyrës së infrastrukturës (rrugë, trotuare), ndërsa ato të refuzuara lidhen me kërkesa për restaurim objektsh kulturore dhe me investime në rrethoja të varrezave. Komuna nuk i ka teguar arsyet e refuzimit të kërkesave të kësaj natyre.

Tutje, tri projektet kapitale me investimin me të lartë të realizuar në Drenas gjatë periudhës 2018–2023 janë: ndërtimi i rrugës Drenas-Komorani (bashkëfinancim mes komunës dhe Ministrisë së Infrastrukturës), ndërtimi i ujësjellësit në zonën veriore që përfshin 11 fshatra, si dhe ndërtimi i shkollës së mesme profesionale (bashkëfinancim mes komunës dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë).

2.3 Komuna e Kaçanikut


Buxheti i komunës së Kaçanikut për investime kapitale në mesatare gjatë viteve është rreth 2.3 milionë euro. Duke krahasuar periudhën mes viteve 2018 dhe 2023, vërehet ka pasur një rritje prej 29% (nga 1.6 milionë euro në 2.1 milionë euro). Megjithatë, në 2020 pati një rënie prej 9.3% (në 1.9 milionë euro), kjo për shkak të pandemisë COVID-19. Viti 2021 shënoi një rritje të lehtë prej 1.9%, pasuar nga një rritje më e madhe prej 11% në 2022 (në 2.2 milione euro), ndërsa viti 2023 shënoi rritjen më të madhe, me 29% (në 2.8 milionë euro), duke treguar një përmirësim të ndjeshëm të kapacitetit buxhetor të komunës për investime.

Figura 7. Buxheti për investime kapitale në Kaçanik 2018 – 2023



Infrastruktura ka qenë prioriteti kryesor i komunës, me shumata më të larta të alokuara çdo vit, duke arritur pikun në vitin 2023 me afro një milionë euro, një rritje kjo prej afro 26% krahasuar me vitin 2018. Vlera më e ulët ishte në vitin 2020 me 625 mijë euro një rënie prej 16% nga viti 2018.

Figura 8. Shpërndarja e buxhetit sipas fushave kryesore në Komunën e Kaçanikut përgjatë viteve 2018 – 2023



Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumata kryesore të financiarra nga ana e kësaj komune.

Arsimi ka shfaqur një trend rritës të qëndrueshëm nga viti 2018 deri në 2022, duke arritur vlerën prej 375 mijë euro nga 211 mijë euro, një rritje prej 77%. Megjithatë, në vitin 2023 pati një rënie të lehtë në 305 mijë euro që është gjithsesi 44% më e lartë se në 2018.

Shëndetësia ka pasur një rritje graduale nga viti 2018 deri në 2020, duke arritur në 175 mijë euro, një rritje prej afro 36%. Por më pas ka pësuar rënie, duke arritur në zero në vitin 2023, një rënie prej 100% krahasuar me vitin 2018.

Kultura ka pasur një rritje të konsiderueshme, veçanërisht në vitet e fundit. Nga një buxhet i qëndrueshëm prej 30 mijë euro në vitet 2018–2020, ai u rrit dukshëm, duke arritur në 190 mijë euro në vitin 2023, një rritje të madhe prej 533% krahasuar me vitin 2018.

Bujqësia ka pasur një buxhet të qëndrueshëm prej 50 mijë euro për shumicën e viteve, me përjashtim të vitit 2022 kur nuk u alokuan fonde). Në vitin 2023 buxheti i ndarë për bujqësi ishte 50 mijë euro, në të njëjtin nivel me atë të vitit 2018.

Tabela 4. Shpërndarja e investimeve kapitale në Kaçanik sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018 – 2023

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Doganaj	5,000	80,000	175,000	80,000	30,000	80,000	450,000
Begracë		25,000	45,000	150,000		210,000	430,000
Biqec	30,000	30,000	40,000	5,000	150,000	100,000	355,000
Bob	5,000	20,000		105,000	5,000	200,000	335,000
Ivajë	35,000	150,000	5,000	5,000	5,000	5,000	205,000
Gajre	50,000	100,000	50,000				200,000
Bajnicë	30,000					150,000	180,000
Gllloboçicë	40,000	60,000					100,000
Stagovë		20,000			50,000		70,000
Kovaçecë	30,000	20,000					50,000
Kotlinë	40,000	5,000					45,000
Runjevë	30,000			5,000	5,000	5,000	45,000
Sllatinë	25,000	20,000					45,000
Semajë		20,000	5,000				25,000
Kacaniku i Vjetër			5,000			5,000	10,000
Dubravë			5,000	5,000			10,000
Nikovc						5,000	5,000
Rakaj		5,000					5,000
Gjithsej							2,565,000

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbrasura nënkupton se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet. Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Kaçaniku gjatë periudhës 2018–2023 për investime kapitale ka pasur në dispozicion gjithsej 12.7 milionë euro, nga të cilat 2.5 milionë euro (20%) janë investuar në zona rurale dhe mbi 10 milionë euro (80%) në zona urbane.

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë për komunën e Kaçanikut, lokalitetet rurale që kanë përfituar më shumë buxhet janë Doganaj me 450 mijë euro, Begracë me 430 mijë euro, dhe Biqec me 355 mijë euro. Këto lokalitete kanë pasur investime me të larta dhe të vazhdueshme gjatë viteve të analizuar. Kaçaniku ka 29 lokalitete, prej të cilave 31% (9) nuk kanë përfituar, 31% (9) kanë përfituar pjesërisht ose së paku në tri nga gjashtë vite, 37.9% (11) kanë përfituar vazhdimisht ose së paku në pesë nga gjashtë vite.

Disa lokalitete kanë përfituar pak ose aspak buxhet, për shembull, Nikovc ka përfituar vetëm 5 mijë euro, ndërsa Kaçaniku i Vjetër dhe Dubrava kanë përfituar nga 10 mijë euro secila. Këto shifra tregojnë një shpërndarje jo të barabartë të investimeve. Lokalitetet që nuk kanë përfituar fare buxhet gjatë kësaj periudhe janë: Gjurgjedell, Drenogllavë, Gabricë, Nikaj, Mahalla e Hoxhajve, Gërllicë e Epërme, Korboliq, Rekë, Vërtollnicë dhe Strazhë.


Vlen të theksohet se në disa lokalitete ka pasur investime në vite të caktuara, si për shembull në Bajnicë 150 mijë euro në 2023, në Bob 200 mijë euro në 2023, dhe në Ivajë 150 mijë euro në 2019. Komuna e Kaçanikut gjatë vitit 2023 nuk ka publikuar të dhëna apo informata lidhur me konsultimet publike.

Projektet më të kushtueshme infrastrukturore në Komunën e Kaçanikut gjatë periudhës 2018-2023 janë: ndërtimi i rrugës Kaçanik-Hani i Elezit, ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza si dhe ndërtimi i palestrës sportive. Tutje, komuna e Kaçanikut nuk i ka publikuar raportet e konsultimeve buxhetore me qytetarë të zhvilluara gjatë viteve 2022 dhe 2023.

2.4 Komuna e Podujevës


Buxheti i komunës së Podujevës për investime kapitale ka tejkaluar shifrën prej 9 milionë eurove në vit. Viti 2019 shënoi rritjen më të madhe me afro 86% krahasuar me 2018, duke arritur në 12 milionë euro. Megjithatë, në 2020 pati një rënie të ndjeshme prej afro 22%. Trendi rënës vazhdoi në 2021 dhe 2022, me ulje përkatësisht prej 23.5% dhe 10.3%. Viti 2023 shënoi një rikthim me një rritje prej 42% krahasuar me 2022, duke arritur në 9.2 milionë euro, megjithëse ende nën nivelin e pikut të 2019.

Figura 9. Buxheti për investime kapitale në Podujevë 2018 – 2023



Ngjajshëm si në komnatat e tjera, infrastruktura prin si përqindje dhe si vlerë absolute në alokimin e fondeve nga buxheti i kapitaleve.

Figura 10. Shpërndarja e buxhetit sipas fushave kryesore në Komunën e Podujevës përgjatë viteve 2018 – 2023



Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiarë nga ana e kësaj komune.

Arsimi ka pasur një rritje të madhe në vitin 2023, me një investim prej 1.6 milionë euro, që është shtatë herë më i lartë se vitet e mëparshme. Shëndetësia ka pasur investime relativisht të qëndrueshme, me një mesatare prej rreth 570 mijë euro në vit.

Investimet në kulturë kanë pasur një rritje të lehtë në vitin 2023 duke arritur vlerën prej 310 mijë euro. Ndërkohë, bujqësia ka pasur investime sporadike, me një maksimum prej 150 mijë euro në vitin 2019, por pa investime në vitet 2022 dhe 2023.

Tabela 5. Shpërndarja e investimeve kapitale në Podujevë sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018- 2023

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Siboc i Poshtëm	30,000	35,000	75,000	175,000	500,000	40,000	855,000
Bajqinë	65,000	40,000	95,000	10,000	340,000	60,000	610,000
Gërdoc		50,000		10,000	550,000		610,000
Llapashticë e Poshtme	200,000	100,000	55,000	85,000	70,000		510,000
Revuç	55,000			30,000	340,000	60,000	485,000
Ballovc	50,000	140,000	100,000	100,000		30,000	420,000
Dobratin	91,000	159,000	50,000	60,000			360,000
Lupç i Poshtëm	140,000	74,000	55,000	60,000		30,000	359,000
Dumnicë e Poshtme	75,000		50,000	175,000		50,000	350,000
Batllavë	15,000	175,000	100,000	10,000		40,000	340,000
Llugë	60,000		40,000		217,000		317,000
Gllamnik		75,000	70,000	35,000	30,000	90,000	300,000
Llapashticë e Epërme	85,000	45,000	35,000	40,000		90,000	295,000
Peran	75,000			36,000	100,000	30,000	241,000
Dumosh	135,000			50,000		40,000	225,000
Bradash	85,000		80,000	10,000		30,000	205,000
Letanc		60,000	20,000	40,000	45,000	30,000	195,000
Dumnicë e Epërme	135,000		50,000	10,000			195,000
Sveçël					160,000	30,000	190,000
Surkish	45,000	110,000		33,000			188,000
Pakashticë e Poshtme		35,000	40,000	82,000		30,000	187,000
Pakashticë		45,000	40,000			90,000	175,000
Lladoc	50,000	50,000		55,000		20,000	175,000
Zhiti	130,000		45,000				175,000
Pollatë	55,000	63,000	45,000				163,000
Lluzhan	45,000	60,000		10,000		40,000	155,000
Lupç i Epërm		110,000	40,000				150,000
Hërticë		50,000	45,000	55,000			150,000
Tërrnav		149,000					149,000
Murgull	85,000	55,000					140,000

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Miroc	85,000			50,000			135,000
Dyz	80,000	50,000					130,000
Orllan			40,000	10,000		70,000	120,000
Turuçicë	55,000			10,000		50,000	115,000
Halabak		33,000	50,000	10,000		20,000	113,000
Metergoc		55,000		57,000			112,000
Sllatinë		60,000				50,000	110,000
Kërpimeh		100,000					100,000
Buricë			40,000	55,000			95,000
Majac	15,000		50,000	10,000		20,000	95,000
Bellopojë			50,000	10,000		30,000	90,000
Sallabajë	50,000	30,000		10,000			90,000
Llaushë				85,000			85,000
Shakovicë	85,000						85,000
Kushevicë	15,000			69,000			84,000
Siboc i Epërm	50,000					30,000	80,000
Reçicë	45,000					35,000	80,000
Potok		75,000					75,000
Godishnjak			40,000	10,000		20,000	70,000
Kunushec	70,000						70,000
Livadicë			35,000	10,000		25,000	70,000
Metohi		45,000		20,000			65,000
Shajkoc			30,000	33,000			63,000
Rep			45,000	10,000			55,000
Surdull	45,000						45,000
Penuh			40,000				40,000
Popovë				40,000			40,000
Obrangj						39,500	39,500
Zakut			30,000				30,000
Dobërdol	15,000			10,000			25,000
Sylevicë				10,000			10,000
Gjithsej							11,285,500

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbrastura nënkupton se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet. Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Podujeva gjatë periudhës 2018–2023 ka pasur në dispozicion mbi 50 milionë euro për investime kapitale prej të cilave afro 12 milionë euro (23%) janë shpenzuar ose dedikuar në zona rurale dhe 39 milionë euro (77%) në zona urbane.

Vlerësuar sipas shpërndarjes së buxhetit të kapitaleve për lokalitetet e Komunës së Podujevës gjatë viteve 2018–2023, rezulton se Siboci i Poshtëm ka marrë shumën më të lartë të investimeve, pasuar nga Bajçina. Balloci dhe Revuçi gjithashtu kanë përfituar nga investime të mëdha, me shumën përkatësisht prej 420 mijë dhe 485 mijë euro. Shikuar në total Podujeva ka 80 lokalitete, prej të cilave 20% (16) nuk kanë përfituar, 35% (28) kanë përfituar pjesërisht, 45% (36) kanë përfituar vazhdimisht. Një tipar i dukshëm është luhajtja e ndjeshme e financimeve nga viti në vit për shumë lokalitete.

Ndërsa gjatë periudhës 2018–2023 nuk janë evidentuar investime në këto lokalitete: Barainë, Bllatë, Brainë, Brecë, Bërvenik, Dvorishtë, Kaçybeg, Kalaticë, Muhazob, Merdar, Përpellac, Radujevë, Rakinicë, Shtedim, Terrnavicë dhe fshati Velikarekë.


Projektet më të kushtueshme infrastrukturore në Komunën e Podujevës gjatë periudhës 2018–2023 janë ndërtimi i shkollës së re "Naim Frashëri", ndërtimi i sheshit të Podujevës si dhe ndërtimi i qendrës së emergjencës.

Gjatë vitit 2023 Komuna e Podujevës ka zhvilluar gjithsej tri konsultime buxhetore me qytetarë, ku pjesëmarrja e tyre ka qenë tejet e ulët, vetëm 37 qytetarë, por që ka rezultuar me paraqitjen e shumë kërkesave (gjithsej 91 kërkesa të paraqitura, 53 prej të cilave janë marrë parasysht). Edhe të rasti i Podujevës kërkesat me të shpeshta kanë qenë për rregullim të rrugëve, trotuarëve, instalimin e ndriçimit publik, ndërsa kërkesat kryesisht të refuzuara rezultojnë ato që lidhen me zgjerimin e ujësjellësëve, kanalizimit dhe ujitjen e tokave bujqësore. Arsyet e refuzimit të këtyre kërkesave kanë ardhur për shkak se të rasti i ujësjellësëve kjo ka kaluar në përgjegjësi të plotë të KRU "Prishtina", kurse të rasti i kërkesave për kanalizim, kërkesat janë refuzuar me arsyetimin se derdhja e ujërave fekaleve është paraparë të bëhet në rrjedhën e lumit dhe komuna nuk mund të bëjë këtë. Dhe është propozuar hartimi i një projekti që do të shmangë derdhjen e këtyre ujërave në lum, ndërsa për ujitjen e tokave bujqësore nuk është hasur ndonjë arsyetim i dhënë për refuzimin e tyre.

2.5 Komuna e Prizrenit


Buxheti i komunës së Prizrenit për investime kapitale ka pësuar ndryshime të konsiderueshme nga viti 2018 deri në 2023. Nga 2018 në 2019, pati një rritje të ndjeshme prej 29%. Megjithatë, në vitin 2020 pati një rënie të lehtë prej 1.2%. Viti 2021 shënoi një rënie më të madhe prej 17% krahasuar me vitin paraprak. Në 2022, buxheti u rrit lehtësisht me 3%. Ndryshimi më i madh ndodhi në vitin 2023, me një rritje të jashtëzakonshme prej 60% krahasuar me vitin 2022, duke arritur në 43 milionë euro. Kjo rritje e fundit tregon një potencial të madh të kësaj komune për të investuar në projektet kapitale.

Figura 11. Buxheti për investime kapitale në Prizren 2018 – 2023



Vlerësuar sipas shpërndarjes së kapitaleve sipas fushave, vërehet një trend i ndryshëm në shpërndarjen e buxhetit. Infrastruktura ka pasur rritjen më të madhe, nga 8.8 milionë në 2018 në 12.1 milionë në 2023, që paraqet një rritje prej rreth 37%.

Figura 12. Shpërndarja e buxhetit të kapitaleve sipas fushave kryesore në Komunën e Prizrenit përgjatë viteve 2018 – 2023



Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiare nga ana e kësaj komune.

Arsimi ka pasur luhatje, me një rritje të konsiderueshme në 2020 (2.5 milionë), por pastaj ka rënë në nivele të ngjashme me 2018 (1.8 milionë në 2023). Shëndetësia ka shënuar rritje të përgjithshme, nga 842 mijë në 2018 në 1.3 milionë euro në 2023, që tregon një investim të shtuar në këtë sektor.

Kultura ka pësuar një rënie të lehtë, duke rënë nga 1.1 milionë euro në 2018 në 1 milionë euro në 2023. Ndërkohë, bujqësia ka pësuar rënie më të madhe, duke u ulur nga 1.3 milionë euro në 2018 në vetëm 325 mijë euro në 2023, që paraqet një rënie prej 75%. Kjo tregon një zhvendosje të konsiderueshme të prioriteteve buxhetore duke renditur të fundit sektorin bujqësor.

Tabela 6. Shpërndarja e investimeve kapitale në Prizren sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018 – 2023

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Zhuri	250,000	190,000	250,000	140,000	190,000	250,000	1,270,000
Hoça e Qytetit	150,000	20,000	250,000	60,000	20,000	100,000	600,000
Korisha	250,000	50,000	110,000	45,200			455,200
Novaka			250,000	70,000	70,000		390,000
Manastirica	80,000		150,000	80,000	65,000		375,000
Vlashnja		100,000	50,000	100,000	70,000	50,000	370,000
Kabashi	83,000	15,000	100,000	60,000	50,000	40,000	348,000
Billusha	80,000	70,000	50,000	50,000	20,000	75,000	345,000
Pirana	140,000	80,000	10,000	20,000	20,000	45,000	315,000
Gjonaj	50,000	30,000	20,000	110,000		100,000	310,000
Breg-Drini	80,000	20,000	150,000	20,000	30,000		300,000

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Atmaxhë	49,403	100,000	20,000	50,000	20,000	50,000	289,403
Mazreku	70,000	50,000		70,000	70,000	20,000	280,000
Lubizhda	119,000			100,000	60,000		279,000
Randobrava	174,000			80,000	15,000		269,000
Jeshkova	30,000	20,000	50,000	110,000		50,000	260,000
Dedaj	27,000	130,000	20,000	25,000		50,000	252,000
Landovica		50,000		50,000	100,000	40,000	240,000
Zhivinjani			40,000	100,000	100,000		240,000
Zozji	40,000	70,000		70,000		50,000	230,000
Trepetnica		30,000	50,000	30,000	70,000	45,000	225,000
Velezha		70,000		70,000	30,000	50,000	220,000
Medveci	20,000	44,000	30,000	20,000	70,000	35,000	219,000
Grazhdaniku	20,000	20,000	50,000		50,000	50,000	190,000
Nëpërgoshti			20,000	80,000	90,000		190,000
Shkoza		70,000		70,000	20,000	30,000	190,000
Lutogllava		50,000	20,000	90,000	20,000		180,000
Milaj			83,000		50,000	40,000	173,000
Krusha e Vogël	50,000	20,000		55,000		40,000	165,000
Malësia e Re	80,000		50,000	20,000	15,000		165,000
Kobaj	50,000			90,000	20,000		160,000
Smaçi	100,000			30,000		30,000	160,000
Nasheci	30,000		50,000	30,000	50,000		160,000
Caparci	50,000			20,000	20,000	50,000	140,000
Novosella				20,000	110,000		130,000
Mushnikova		73,000				50,000	123,000
Sërbica e Poshtme	80,000			20,000	20,000		120,000
Kushtendili	10,000				50,000	50,000	110,000
Petrovasella			50,000		20,000	40,000	110,000
Dobrushta		10,000	30,000			50,000	90,000
Gorozhupi		20,000	20,000			50,000	90,000
Reçana				70,000	20,000		90,000
Kojusha	20,000	50,000			15,000		85,000
Karashëngjergji						75,000	75,000
Krajku						70,000	70,000
Planeja					30,000	40,000	70,000

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Srecka		20,000				45,000	65,000
Muradema	20,000	20,000		20,000			60,000
Kabashi i Hasit						55,000	55,000
Jabllanica						50,000	50,000
Pllanjani				30,000	20,000		50,000
Shpinadia			50,000				50,000
Vërmica	50,000						50,000
Lubinja e Epërme						45,000	45,000
Leskoveci						40,000	40,000
Romaja				20,000	20,000		40,000
Kushnini						35,000	35,000
Gjithsej							11,657,603

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbratura nënkupton se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet.
Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Komuna e Prizrenit është komuna me shkallën më të lartë për investime kapitale në mesin e 15 komunave që vlerëson ky raport, me gjithsej 185 milionë euro gjatë viteve 2018–2023, prej të cilave afro 12 milionë euro (6.3%) janë investuar në zona rurale, ndërsa 174 milionë euro (93.7%) në zona urbane.

Prizreni ka 83 lokalitete rurale, prej të cilave 19%(16) nuk kanë përfituar asnjëherë gjatë gjashtë viteve, 41% (33) kanë përfituar pjesërisht (se paku dy herë në gjashtë vite), 40% (34) kanë përfituar vazhdimisht. Vlerësimi i ndarjes buxhetore në kapitale për lokalitetet e Komunës së Prizrenit gjatë periudhës 2018–2023 paraqet disa trende dhe informacione të rëndësishme. Zhuri del në pah si lokaliteti me shumën më të madhe të alokuar, duke marrë një total prej 1.2 milionë euro. Kjo shumë është dukshëm më e lartë se ajo e lokaliteteve të tjera, duke treguar një fokus të veçantë në zhvillimin e kësaj zone. Ky lokalitet ka marrë financim të konsiderueshëm çdo vit, me shuma që variojnë nga 140 mijë euro deri në 250 mijë euro në vit.

Pas Zhurit, lokalitetet me shumën më të mëdha janë Novaka me 390 mijë euro, Manastirica me 375 mijë euro, dhe Vlashnja me 370 mijë euro. Këto shifra sugjerojnë një shpërndarje jo të barabartë të burimeve, me disa lokalitete që marrin shumë më shumë financim se të tjerat.


Një trend i dukshëm është se shumica e lokaliteteve kanë marrë financim të paqëndrueshëm gjatë viteve, me disa vite që kanë shuma të konsiderueshme dhe të tjera pa financim fare. Vërehet gjithashtu se disa lokalitete si: Dojnica, Drajçiqi, Gërçari, Gornjasella, Lezi, Llokuvica, Lubinja e Poshtme, Lybeqeve, Lubizhda e Hasit, Lukinaj, Poslishti, Pouska, Sërbica e Epërm, Skorobishti, Struzha dhe Tupeci nuk kanë marrë asnjë financim gjatë kësaj periudhe gjashtëvjeçare.

Komuna e Prizrenit, publikon të gjitha raportet që lidhen me konsultimet e qytetarëve gjatë hartimit të buxhetit, por për shkak të mos funksionimit të rregullt të uebfaqes zyrtare ka qenë e pamundur qasja në këto dokumente. Ndryshe, projektet me të kushtshme në Prizren gjatë periudhës 2018 – 2023 janë ndërtimi i kompleksit sportiv "Sezai Surroi", rehabilitimi dhe zgjerimi i rrugës në hyrje të Prizrenit tek pjesa e autostradës si dhe zgjerimi i rrugës Prizren – Gjakovë, pjesa hyrëse e qytetit.

2.6 Komuna e Rahovecit


Në komunën e Rahovecit për periudhën 2018–2023, shihet një trend i ndryshueshëm në investime kapitale. Nga 2018 deri në 2020 ka pasur një rënie graduale, me uljen më të madhe prej 7% nga 2019 në 2020. Megjithatë, nga viti 2021 fillon një rritje e vazhdueshme. Rritja më e madhe vërehet në vitin 2023 me një shtim prej 37% krahasuar me vitin paraprak, duke arritur në 5.6 milionë euro.

Figura 13. Buxheti për investime kapitale në Rahovecit 2018 – 2023



Shikuar sipas fushave, komuna e Rahovecit i ka dhënë prioritet infrastrukturës dhe bujqësisë. Kultura ka pasur rritjen më të qëndrueshme, ndërsa arsimit dhe shëndetësisë kanë pasur luhata të mëdha. Këto ndryshime mund të reflektojnë prioritetet e ndryshme të komunës ose ndikimin e faktorëve të jashtëm si pandemia COVID-19. Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha fushat, përveç infrastrukturës, kanë përfunduar me nivele më të larta financimi në 2023 krahasuar me 2018, duke sugjeruar një trend të përgjithshëm pozitiv në investimet komunale.

Figura 14. Shpërndarja e buxhetit të kapitaleve sipas fushave kryesore në Komunën e Rahovecit përgjatë viteve 2018 – 2023



Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiare nga ana e kësaj komune.

Infrastruktura nga një nivel i lartë prej 2 milionë euro në 2018, pati një rënie prej 47% në 2019. Megjithatë, nga 2020 e tutje, ka pasur një rritje graduale, duke arritur në 1.4 milionë euro në 2023, që është 36% më e lartë se në 2019, por ende 31% më e ulët se në 2018.

Fusha e arsimit ka pasur ndryshime të mëdha. Pas një rritjeje prej 29% nga 2018 në 2019, pati një ndërprerje totale të financimit në 2020 dhe 2021. Financimi u rikthye në 2022 me 507 mijë euro dhe u rrit me 14% në 2023, duke arritur në 580 mijë euro, që është 40% më shumë se në 2018.

Shëndetësia ka pasur një trajektore jo të qëndrueshme. Pas një rritje të lehtë në 2019, pati një rënie në 2020 dhe 2021. Megjithatë, financimi është rritur ndjeshëm në 2022 dhe 2023, duke arritur në 595 mijë euro në 2023, që është 32% më shumë se në 2018.

Kultura ka pasur një trend kryesisht pozitiv. Pavarësisht një rënie të lehtë në 2019, financimi është rritur çdo vit pas kësaj, duke arritur në 505 mijë euro në 2023, që është 106% më shumë se në 2018.

Bujqësia vërehet se është fushë që komuna i ka kushtuar në vazhdimësi vëmendje. Nga viti 2018 në 2019, pati një rritje të madhe prej 129%, duke mbetur relativisht e qëndrueshme deri në 2021. Megjithatë, pati një rënie të ndjeshme prej 23% në 2022, para se të rritet përsëri në 2023, duke arritur në mbi 1 milionë euro, që është 134% më shumë se në 2018.

Tabela 7. Shpërndarja e investimeve kapitale në Rahovec sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018 – 2023

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Kramovik	60,000	10,000	70,000	90,000		90,000	320,000
Opterushë		30,000	140,000	50,000	40,000	60,000	320,000
Krushë e Madhe	50,000	50,000	80,000	30,000	45,000	55,000	310,000
Ratkoc	37,000	20,000	30,000	80,000	30,000	50,000	247,000
Hocë e Vogël	33,000	70,000		43,000		90,000	236,000
Retijë		80,000	50,000	43,000		60,000	233,000
Celinë	25,000	10,000	20,000	50,000	90,000	60,000	225,000
Pastasellë	25,000	45,000	45,000	50,000		50,000	215,000
Hoçë e Madhe		50,000	50,000		50,000	60,000	210,000
Zatriq	100,000	50,000	20,000			40,000	210,000
Mrasor	25,000		100,000			60,000	185,000
Xërxë	25,000	50,000	80,000			25,000	180,000
Drenoc	6,600	20,000	70,000		40,000	40,000	176,600
Çifllak	8,000	40,000	70,000			50,000	168,000
Dejnë	15,000	30,000	30,000	5,000	50,000	35,000	165,000
Brestoc	25,000	10,000	20,000	100,000			155,000
Bellacërkë	50,000		80,000				130,000
Nagavc		15,000	100,000				115,000
Kaznik				59,857		55,000	114,857
Senoc		20,000	30,000			55,000	105,000
Bërnjak						95,000	95,000
Pataçan i Epërm		60,000	30,000				90,000
Gegjë		20,000	50,000				70,000
Pataçan i Poshtëm		30,000					30,000
Gjithsej							4,305,457

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbrasura nënkuptojnë se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet. Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Komuna e Rahovecit gjatë periudhës 2018–2023 ka pasur në dispozicion mbi 26 milionë euro, prej të cilave 4.3 milionë euro (16%) janë shpenzuar në zona rurale dhe afro 22 milionë euro (84%) në zona urbane.

Shtatë lokalitete apo 21% e gjithsej vendbanimeve kanë përfituar investime në katër deri gjashtë vite, dhe ato janë: Krusha e madhe, Ratkoc, Celinë, Kramovik, Opterushë, Pastasellë dhe Dejnë.

Gjithsej 17 lokalitete apo 51.5% e totalit kanë përfituar investime të pjesshme dhe ato janë: Hoçë e Vogël, Retijë, Hoçë e Madhe, Zatriq, Mrasor, Xërxë, Drenoc, Çifllak, Brestoc, Bellacërkë, Nagavc, Kaznik, Senoc, Bërnjak, Pataçan i Epërm, Gegjë dhe Pataçan i Poshtëm.

Në 8 lokalitete ose 27% e totalit nuk ka pasur asnjë investim gjatë kësaj periudhe dhe ato janë: Bratotinë, Dobidol, Nushpal, Petkoviç, Polluzhë, Radostë, Blata, Zhdrellë. Një trend interesant është shfaqja e investimeve të vonshme në disa lokalitete. Për shembull, Bërnjak dhe Kaznik të cilat kanë filluar të marrin fonde domethënëse vetëm në vitet e fundit të periudhës 2023.


Rahoveci gjatë vitit 2023 ka organizuar katër konsultime buxhetore me qytetarë, ku pjesëmarrës kanë qenë 153 persona, dhe janë parashtruar 144 kërkesa, prej të cilave 48 janë përfshirë në buxhetin përkatës të kësaj komune. Kërkesat që janë konsideruar jo të pranueshme lidhen me rritjen e shumës së mjeteve financiare që përfitojnë fermerët dhe bujqit e kësaj komune, investime në ujitjen e tokave bujqësore si dhe rregullimin e rrugëve private të lagjeve, pa pasur rrugët karakter publik. Arsyeja e refuzimit të këtyre kërkesave kryesisht ka pasur të bëjë për shkak se rritja e fondeve për subvencione do të binte ndesh me qarkoret buxhetore të Ministrisë së Financave, ndërsa të pjesa e rrugëve private komuna cilëson se nuk është kompetente të investojë në rrugët private.

Projektet kapitale më të kushtueshme në Rahovec gjatë periudhës 2018 – 2023 janë: ndërtimi i rrugës Rahovec-Xërxe, ndërtimi i impiantit për përpunimin e ujit të pijshëm për 12 fshatra, si dhe ndërtimi i qendrës së re të kulturës në qendër të qytetit.

2.7 Komuna e Ferizajt


Buxheti i komunës së Ferizajt për investime kapitale ka pësuar ndryshime të konsiderueshme nga viti 2018 deri në 2023. Nga 9.5 milionë euro në 2018, pati një rritje të madhe prej 59% në 2019, duke arritur në 15 milionë euro. Megjithatë, në 2020 pati një rënie prej 19% në 12 milionë euro, pasuar nga një rënie tjetër prej 10% në 2021. Viti 2022 shënoi rënien më të madhe prej 15%, duke zbritur në 9.4 milionë euro. Në vitin 2023 u pa një rikuperim i konsiderueshëm me një rritje prej 29%, duke arritur në 12 milionë euro. Pavarësisht luhatjeve, buxheti i 2023 është 27% më i lartë se ai i 2018.

Figura 15. Buxheti për investime kapitale në Ferizaj 2018 – 2023



Orientimi i kapitaleve në fusha karakterizohet me një ndryshim në prioritetet e shpenzimeve të komunës, me një zhvendosje të dukshme drejt bujqësisë dhe një rinovim të fokusit në shëndetësi në vitet e fundit. Ndërkohë, sektorët si arsimi dhe kultura duket se kanë pësuar ulje në financim.

Figura 16. Shpërndarja e buxhetit të kapitaleve sipas fushave kryesore në Komunën e Ferizajt përgjatë viteve 2018 – 2023



Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiare nga ana e kësaj komune.

Infrastruktura ka pasur luhatje të konsiderueshme, me shumën më të lartë prej 12 milionë euro në vitin 2019, por ka rënë ndjeshëm në vitet e mëvonshme, duke arritur në 7 milionë euro në 2023. Arsimi ka pasur një rritje graduale deri në 2022, por ka pësuar një rënie të theksuar në 2023.

Shëndetësia është karakterizuar me një rënie të vazhdueshme nga 2018 deri në 2021, por pastaj një rritje të theksuar në 2023 me 510 mijë euro. Kultura ka pësuar luhatje të mëdha, duke arritur zero në 2021, por duke u rikuperuar pjesërisht në vitet pasuese. Bujqësia tregon një trend pozitiv, me një rritje të ndjeshme në 2023, duke arritur në 960 mijë euro që është gati katër herë më shumë se në 2018.

Tabela 8. Shpërndarja e investimeve kapitale në Ferizaj sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018 – 2023

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Komogllavë	345,800	120,000	413,000	90,000	450,000	1,100,509	2,519,309
Koshare		110,000	230,000	150,000	235,000	400,432	1,125,432
Greme		25,000	280,000	280,000	430,000	50,000	1,065,000
Sojevë	50,000	20,000	100,000	50,000	285,000	315,000	820,000
Bibaj	158,457		50,000	40,000	200,000	300,000	748,457
Bablak		70,000	130,000	135,000	204,000	130,000	669,000
Pojatë	30,000	79,628	150,000			350,000	609,628
Muhaxher-talinovc	29,701	125,449	250,000	30,000	130,000		565,150
Jerliprelez	50,000	87,000	67,465	58,813	204,000	30,000	497,278
Rakaj	10,000	50,000	80,000	50,000	230,000	50,000	470,000
Kosinë	20,000			20,000	214,000	150,000	404,000

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Manastirc	111,658	110,000	90,000	10,000	50,000		371,658
Jezerc	50,000	50,000	20,000	20,000	30,000	200,000	370,000
Slivovë		117,998	200,000			50,000	367,998
Mirash	80,000	39,837	85,000	50,000	80,000		364,837
Mirosalë			50,000	60,000	240,000		350,000
Prelezi Muhaxher	174,435	60,000		40,000	70,000		344,435
Cernillë			55,000	75,000	100,000	100,000	330,000
Doganaj	30,000	25,000	50,000	90,000		120,000	315,000
Gërlinë e Ultë	15,000				170,000	120,000	305,000
Varosh	10,000				140,000	150,000	300,000
Tërn	30,000	70,000	49,000		50,000	100,000	299,000
Zllatar		170,000	20,000	50,000		50,000	290,000
Softaj	40,000	19,372	56,347	40,000	40,000	70,000	265,719
Nerodimja e Epërme	30,000	212,000					242,000
Nerodimja e Ultë		66,588	39,816		70,000		176,404
Papaz	30,000	70,000	52,316				152,316
Lloshkobare	1,000	66,469	25,985	30,000			123,454
Babushë					10,000	100,000	110,000
Zaskok			10,000		100,000		110,000
Rahovicë	27,530		22,299			50,000	99,829
Muhoc	12,000				80,000		92,000
Dramjak				50,000			50,000
Jerlitalinovc						40,000	40,000
Gjithsej							14,962,904

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbrasura nënkuptojnë se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet. Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Gjatë periudhës 2018–2023, Komuna e Ferizajt ka shpenzuar për investime kapitale afro 70 milionë euro, prej të cilave rreth 15 milionë euro (21%) u janë dedikuar zonave rurale, kurse mbi 54 milionë euro (79%) zonave urbane.

Vlerësimi i shpërndarjes së buxhetit të kapitaleve në komunën e Ferizajt tregon një pabarazi të konsiderueshme në investimet ndërmjet lokaliteteve të ndryshme gjatë periudhës 2018–2023. Komogllava del si përfituesi më i madh me një total prej 2.5 milionë euro, duke pasur një rritje të ndjeshme të investimeve në vitin 2023. Koshare dhe Greme gjithashtu kanë përfituar shuma të konsiderueshme, përkatësisht 1.1 milionë euro dhe mbi 1 milionë euro, me një shpërndarje relativisht të qëndrueshme përgjatë viteve. Shikuar në tërësi, Ferizaj ka 42 lokalitete prej të cilave 21.5% (9) nuk kanë përfituar, 14.5% (6) kanë përfituar pjesërisht, 64% (27 lokalitete) kanë përfituar vazhdimisht.

Lokalitetet që kanë mbetur pa asnjë investim të regjistruar gjatë kësaj periudhe janë: Baliq, Burrnik, Gatnjë, Nekodin, Sazli, Starosellë, Svrčina dhe Tankosiq dhe Muhaxher. Tendenca e investimeve tregon një qasje të paqëndrueshme për shumicën e lokaliteteve, me vite të karakterizuara nga investime të mëdha të ndjekura nga periudha pa asnjë investim. Megjithatë, disa lokalitete si Bablak, Cernillë dhe Sojevë kanë pasur një qasje më të qëndrueshme në marrjen e fondeve vjetore. Viti 2023 shënoi një rritje të ndjeshme të investimeve për disa lokalitete, veçanërisht Komogllavë, Koshare dhe Sojevë.


Komuna e Ferizajt ka rezultuar në mesin e pak komunave të Kosovës që përfshin numrin me të madh të kërkesave të qytetarëve në planifikimet buxhetore, kërkesa këto që pranohen gjatë konsultimeve publike që zhvillon komuna lidhur me buxhetin. Gjatë vitit 2023, kjo komunë ka mbajtur nëntë konsultime të tilla, ku pjesëmarrës kanë qenë 226 qytetarë dhe kanë parashtruar 171 kërkesa; prej të cilave të pranuar nga komuna dalin 136 kërkesa. Komuna nuk ka dhënë shpjegime në procesverbale se pse një numër i kërkesave janë refuzuar.

Projektet më të kushtueshme infrastrukturore në Komunën e Ferizajt gjatë periudhës 2018–2023 janë: Projekti "Bashkimi i Qytetit": Investim për ndërtimin e nënkalimit që lidh pjesën lindore dhe perëndimore të qytetit, duke përfshirë korsitë për automjete, këmbësorë dhe biçikleta dhe duke shmangur hekurudhën. Dy projekte tjera të mëdha janë: ndërtimi i unazës së qytetit si dhe ndërtimi i kompleksit të ri të spitalit rajonal i cili ka mbetur i pafinalizuar nga periudha para pandemisë e tutje.

2.8 Komuna e Klinës


Buxheti i investimeve kapitale të Komunës së Klinës, ka një trend të përgjithshëm rritës. Nga viti 2018 deri në 2019 pati një rritje të lehtë prej 2.7%. Në vitin 2020, buxheti pësoi një rënie prej 2.8% krahasuar me vitin paraprak. Viti 2021 shënoi një rritje minimale prej 0.1%. Një rritje më e ndjeshme u vu re në vitin 2022 me 8.2% krahasuar me vitin 2021. Rritja më domethënëse ndodhi në vitin 2023 duke arritur vlerën prej 4 milionë euro, një rritje prej 40% krahasuar me vitin 2022.

Figura 17. Buxheti për investime kapitale në komunën e Klinës 2018 – 2023



Të rasti i komunës së Klinës, shpërndarja e kapitaleve është bërë kryesisht në pesë fusha: infrastrukturë, arsim, bujqësi, shëndetësi dhe kulturë.

Figura 18. Shpërndarja e buxhetit të kapitaleve sipas fushave kryesore në Komunën e Klinës përgjatë viteve 2018 – 2023



Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiarë nga ana e kësaj komune.

Infrastruktura ka pasur përparësinë më të madhe, por me disa ndryshime të konsiderueshme. Nga 2018 deri në 2021, pati një rënie graduale, me një ulje prej rreth 21%. Megjithatë, nga 2021 e tutje, ka pasur një rritje të ndjeshme, duke arritur në 2.8 milionë euro në 2023, që përfaqëson një rritje prej rreth 71% krahasuar me vitin 2018.

Në fushën e arsimit nga 202 mijë euro në 2018, u ul në zero në 2020 dhe 2021, për t'u rikthyer në 120 mijë në 2022, por përsëri u ul në zero në 2023. Kjo tregon një mungesë konsistence në financimin dhe prioritizimi e arsimit.

Shëndetësia ka pasur një trend rritës nga 2018 deri në 2021, me shumën më të lartë prej 215 mijë në 2021 (një rritje prej 437.5% krahasuar me 2018). Megjithatë, buxheti u ul në 90 mijë euro në 2023, por që është ende 125% më i lartë se në 2018.

Kultura filloi me zero buxhet në 2018, por pati një rritje të qëndrueshme, duke arritur në 80 mijë euro në 2020. Pavarësisht rënies në 2021, buxheti u rrit përsëri në 55 mijë euro në 2023.

Në fushën e bujqësisë ka pasur një trend rritës të qëndrueshëm, nga 46 mijë euro në 2018 në 160 mijë euro në 2023, që përfaqëson një rritje prej 244%.

Tabela 9. Shpërndarja e investimeve kapitale në Klinë sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018- 2023

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Dollc		15,000		50,000	140,000	290,000	495,000
Shtupel		85,000	50,000	150,000	90,000	70,000	445,000
Volljak	100,000	5,000		75,000	110,000	100,000	390,000
Zajm	17,500	17,000	110,000	40,000	30,000	170,000	384,500
Jashanicë	20,000		60,000	75,000	60,000	150,000	365,000
Gjurgjevik	60,000	120,000		45,000	45,000	95,000	365,000
Siqevë		50,000	75,000	60,000	60,000	65,000	310,000
Grabanicë	17,500	80,000				205,000	302,500
Gllarevë	120,000		10,000	30,000	70,000	50,000	280,000
Krushevë	100,000			50,000	95,000		245,000

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Bokshiq	70,000	40,000	40,000			70,000	220,000
Rudicë	10,000	40,000	50,000	40,000		55,000	195,000
Zllakuqan	40,000		30,000			115,000	185,000
Dugajevë				70,000		110,000	180,000
Videjë			50,000			100,000	150,000
Dollovë		40,000	25,000		70,000		135,000
Dobërdol			65,000	35,000	30,000		130,000
Binqë					40,000	60,000	100,000
Caravik	60,000			30,000			90,000
Dush	70,000	20,000					90,000
Zabërgjë		20,000			70,000		90,000
Drenoc	50,000	35,000					85,000
Berkovë		10,000				65,000	75,000
Budisalc		10,000				55,000	65,000
Prçevë			55,000				55,000
Kpuz	20,000		30,000				50,000
Stupë		40,000					40,000
Klinafc	15,000					10,000	25,000
Jagodë		5,000					5,000
Gjithsej							5,547,000

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbrasura nënkuptojnë se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet. Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Komuna e Klinës për gjashtë vite (2018–2023) ka pasur në dispozicion afro 18 milionë euro, prej të cilave 5.5 milionë (apo 31%) janë investuar në zona rurale ndërkah 12 milionë euro (68%) në zona urbane.

Nisur nga të dhënat në tabelën për komunën e Klinës, mund të vërehet një shpërndarje jo e barabartë e buxhetit në lokalitetet e ndryshme nga viti 2018 deri në 2023. Disa lokalitete kanë përfituar dukshëm më shumë se të tjerat, ndërsa disa nuk kanë marrë asnjë financim gjatë kësaj periudhe. Klina ka 42 lokalitete prej të cilave 31% (13) nuk kanë përfituar, 38% (16) kanë përfituar pjesërisht, 31% (13) kanë përfituar vazhdimisht.

Lokalitetet që kanë përfituar më së shumti përfshijnë Dollcin me 495 mijë euro, Shtupelin me 445 mijë euro, dhe Volljak me 390 mijë euro. Këto lokalitete kanë marrë financime të konsiderueshme dhe të shpërndara gjatë viteve.

Në anën tjetër, lokalitete si Zajmi, Jashanica dhe Gjurgjeviku kanë marrë gjithashtu shuma të konsiderueshme, por pak më të ulëta se grupi i parë.

Disa lokalitete të tjera kanë marrë shumë pak ose aspak financim gjatë kësaj periudhe. Për shembull, Jagoda ka marrë vetëm pesë mijë euro, ndërsa lokalitete si Çabiç, Çeshkovë, Çupevë, Deis, Dobrovodë, Petriq i Ultë, Dranashiq, Dresnik, Dusheviq, Petriq i Epërm, Grebnik, Nagllavë dhe Sverkë nuk figurojnë me asnjë financim gjatë kësaj periudhe gjashtëvjeçare.

Gjatë vitit 2023, Komuna e Klinës ka organizuar shtatë konsultime buxhetore me qytetarë, ku pjesëmarrës kanë qenë 88 qytetarë, të cilët kanë parashtruar 41 kërkesa – prej të cilave 23 janë marrë për bazë nga komuna dhe janë përfshirë në buxhet.

Kërkesat që përgjithësisht janë marrë parasysh kanë qenë: rregullimi i rrugëve, trotuarëve, riparimi i objekteve publike, ndërtimi i fushave sportive si dhe instalimi i ndriçimit publik. Ndërsa nuk janë marrë parasysh nga komuna kërkesat për instalimin e rrjetit të ujësjellësit me arsyetimin e mungesës së burimit të përshtatshëm të ujit.

Projektet më të kushtueshme infrastrukturore në Komunën e Klinës gjatë periudhës 2018–2023 janë: ndërtimi i rrugës Klinë-Volljak, ndërtimi i sistemit të ujësjellësit në zonën jugore, investimi i ri i ujësjellësit që mbulon 8 fshatra në pjesën jugore të komunës si dhe ndërtimi i qendrës së re të mjekësisë familjare në qendër të qytetit.


2.9 Komuna e Kamenicës

Buxheti për investime kapitale i Komunës së Kamenicës ka shfaqur një trend rritës gjatë periudhës 2018–2023. Në vitin 2018, buxheti ishte relativisht i ulët me 124 mijë euro, por pati një rritje të konsiderueshme prej 624% në vitin 2019, duke arritur në 904 mijë euro. Megjithatë, viti 2020 shënoi një rënie prej 28%, duke u ulur në 652 mijë euro, rënie kjo si pasojë e pandemisë COVID-19.

Viti 2021 shënoi një rritje të jashtëzakonshme, me një rritje të buxhetit prej 155% krahasuar me vitin paraprak, duke arritur në vlerë 1.6 milionë euro. Kjo rritje e madhe mund të jetë rezultat i përpjekjeve për rimëkëmbje ekonomike pas pandemisë. Megjithatë, viti 2022 pësoi serish një rënie të lehtë prej 23%, me ulje të buxhetit në 1.2 milionë euro.


Viti 2023 shënoi pikun e buxhetit për këtë periudhë gjashtëvjeçare, me një rritje të konsiderueshme prej 71% krahasuar me vitin paraprak, duke arritur në 2.1 milionë euro. Krahasuar me vitin fillestar 2018, buxheti i vitit 2023 është rritur me një faktor prej 17.5 herë, që tregon për një zgjerim të konsiderueshëm të kapacitetit investues të komunës.

Figura 19. Buxheti për investime kapitale në komunën e Kamenicës 2018 – 2023



Shikuar sipas fushave, infrastruktura ka qenë fusha me prioritetin më të lartë, duke shfaqur një rritje të vazhdueshme dhe të konsiderueshme. Nga 524 mijë euro në vitin 2018, buxheti për infrastrukturë është rritur në 1.2 milionë euro në vitin 2023, që paraqet një rritje prej afërsisht 135%. Kjo tregon një fokus të lartë në zhvillimin e infrastrukturës komunale.

Figura 20. Shpërndarja e buxhetit të kapitaleve sipas fushave kryesore në Komunën e Klinës përgjatë viteve 2018 – 2023



Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiare nga ana e kësaj komune.

Arsimi ka pësuar luhatje të konsiderueshme. Pas një rënie të madhe në 2019 (51 nga 100 mijë euro në 2018), pati një rritje të ndjeshme në 2020 (132 mijë euro). Megjithatë, që nga viti 2022, buxheti për arsim ka mbetur konstant në 36 mijë euro, që është rreth 64% më i ulët se në vitin 2018.

Shëndetësia ka pasur një trend përgjithësisht pozitiv, me rritje të konsiderueshme nga 52 mijë euro në 2018 në 98 mijë euro në 2023, një rritje prej afërsisht 88%. Megjithatë, buxheti ka mbetur i pandryshuar nga 2022 në 2023.

Kultura ka shfaqur një rritje të konsiderueshme. Nga zero buxhet në 2018, ka arritur në 181 mijë euro në 2023. Kjo rritje e madhe, veçanërisht nga 2022 në 2023 (rreth 157%), tregon një fokus të ri në zhvillimin infrastrukturor të kulturës të komunës.

Bujqësia ka filluar të marrë buxhet vetëm nga viti 2021, por ka pasur një rritje të shpejtë. Nga 29 mijë euro në 2021, buxheti është rritur në 169 mijë euro në 2023.

Tabela 10. Shpërndarja e investimeve kapitale në Kamenicë sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018 – 2023

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Hogosht		25,000		29,500	170,000	186,000	410,500
Topanicë						267,050	267,050
Busavatë						245,000	245,000
Koretin						178,000	178,000
Berivojcë						120,000	120,000
Novosellë						85,000	85,000
Muçivërc						70,000	70,000
Karaçevë i poshtme					50,000	17,000	67,000
Hodonoc						50,000	50,000
Moçar					43,000		43,000
Shipashnica e Ultë				29,950			29,950

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Strelicë				29,900			29,900
Gjithsej							1,595,400

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbratura nënkuptojnë se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet. Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Komuna e Kamenicës gjatë periudhës 2018–2023 për investime kapitale ka pasur në dispozicion afro 7 milionë euro, prej të cilave 1.5 milionë euro (23%) u janë dedikuar zonave rurale dhe 5.2 milionë euro (77%) zonave urbane.

Shpërndarja e buxhetit në komunën e Kamenicës sipas lokaliteteve zbulon një model të pabarabartë të investimeve në lokalitete të ndryshme. Hogoshti shfaqet si përfituesi kryesor me 410 mijë euro gjatë viteve 2019–2023, pasuar nga Topanica, Busavata, Koretini dhe Berivojca, të cilat kanë marrë shuma të konsiderueshme në vitin 2023. Ndryshe, Kamenica ka 54 lokalitete prej të cilave 76% (41) nuk kanë përfituar, 22% (12) kanë përfituar pjesërisht dhe nuk ka asnjë lokalitet që ka përfituar vazhdimisht.

Bazuar në ndarjet buxhetore gjatë periudhës 2018–2023 lokalitetet që nuk kanë përfituar janë: Hajnovc, Bllatë, Boscë, Bratilloç, Çarakoc, Dajkoc, Dazhnicë, Desivojcë, Gjyrishec, Feriqevë, Gmicë, Shipashnica e Epërme, Karaçevë i Epërm, Gragjenik, Grizimë, Kolloleq Kopërnice, Kostadincë, Kranidel, Kremenata, Krilevë, Lisockë, Lajçiq, Leshtar, Maroc, Meshinë, Rahovicë, Petroc, Poličkë, Rogaçicë, Shahiq, Sedllar, Strezoc, Svircë, Tërstenë, Tugjec, Vaganesh, Velegllavë e Epërme, Velegllavë e Ultë, Vriqec, Zajçec dhe Zhujë.


Kjo mund të ketë ardhur edhe nga fakti se te Kamenica haset kryesisht buxheti i përgjithësuar, duke u përmendur fushat ose projektet por jo edhe lokalitetet. Buxheti i përgjithësuar, ku nuk specifikohen shpenzimet për lokalitete të veçanta, tregon mungesë transparence dhe vështirëson vlerësimin e drejtë të nevojave dhe efektivitetit të shpenzimeve publike.

Ndryshe, Komuna e Kamenicës ka organizuar numrin më të madh të dëgjimeve buxhetore me qytetarë gjatë vitit 2023, me gjithsej 29 dëgjime të tilla. Edhe numri i pjesëmarrësve ka qenë dukshëm më i lartë, krahasuar me komunat e tjera të përfshira në këtë raport, me 663 qytetarë pjesëmarrës. Në këto dëgjime janë paraqitur gjithsej 352 kërkesa specifike drejtuar komunës, prej të cilave 216 kërkesa janë marrë parasysh. Numri më i madh i kërkesave të aprovuara kanë qenë në fushën e infrastrukturës (rrugë, trotuare, ndriçim publik), ndërsa të refuzuara dalin kërkesat si ndërtimi i qendrave sociale të banimit (për shkak të kostos), si dhe ndërtimi i objekteve të reja shkollore dhe shëndetësore. Te objektet shkollore arsytimi i komunës për refuzim është se MASHT është duke bërë studim se cilat shkolla duhet t'i nënshtrohen risistemimit, ndërsa te objektet shëndetësore arsytimi ka qenë pamundësia e komunave për t'i bërë të njëjtat funksionale, për shkak të mungesës së kuadrit mjekësor.


Projektet më të kushtueshme infrastrukturore në Komunën e Kamenicës gjatë periudhës 2018–2023 janë: ndërtimi i rrugës Kamenicë-Hogosht, ndërtimi i shkollës së mesme "Ismail Qemali" si dhe ndërtimi i sheshit të qytetit i cili akoma nuk është krejtësisht i finalizuar.

2.10 Komuna e Obiliqit

Buxheti i komunës së Obiliqit për investime kapitale ka arritur deri në fund të vitit 2023 në afro 5.5 milionë euro. Nga 2018 në 2019, pati një rritje të jashtëzakonshme prej 189% (në mbi 4 milionë euro). Megjithatë, në 2020 pati një rënie prej 21% (apo me pak për 1.3 milionë euro). Viti 2021 shënoi gjithashtu një ulje të lehtë prej 2.8%. Në 2022, buxheti u rrit me 5% (apo 240 mijë euro), ndërsa në 2023 pati një rritje të mëtejshme prej 9.5% (474 mijë euro). Përgjithësisht, pavarësisht luhatjeve, buxheti i viti 2023 është 154% më i lartë se ai i 2018.

Figura 21. Buxheti për investime kapitale në Obiliq 2018 – 2023

Bazuar në shpërndarjen e kapitaleve në fusha, fusha e infrastrukturës ka pasur rëndësinë më të madhe në buxhet, me një rritje të konsiderueshme nga 1.6 milionë euro në 2018 në 4.3 milionë euro në 2023. Kjo përfaqëson një rritje prej afërsisht 160% gjatë kësaj periudhe. Viti 2019 shënoi rritjen më të madhe, me një rritje prej 154% krahasuar me vitin paraprak.

Figura 22. Shpërndarja e buxhetit të kapitaleve sipas fushave kryesore në Komunën e Obiliqit përgjatë viteve 2018 – 2023

Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiarë nga ana e kësaj komune.

Buxheti për arsim ka pësuar luhatje përgjatë viteve; nga 130 mijë euro në 2018, u rrit ndjeshëm në 683 mijë euro në 2019 (rritje prej 425%). Megjithatë, pas vitit 2019, ka pasur një trend rënës deri në 2022, me një rritje të lehtë në 2023. Pavarësisht rënies, buxheti i 2023 për arsimin është ende 204% më i lartë se ai i 2018.

Buxheti për shëndetësi ka treguar luhatje të mëdha. Piku i tij ishte në 2020 me 800 mijë euro që përfaqëson një rritje prej 788% krahasuar me 2018. Kjo rritje e madhe mund të lidhet me nevojat e shtuara gjatë pandemisë COVID-19. Pas 2020, buxheti ka rënë, por mbetet më i lartë se në nivelet e para 2020.

Buxheti për kulturë ka pasur një rritje të konsiderueshme nga 2018 deri në 2020, duke arritur pikun në 510 mijë euro në 2020 (rritje prej 200% krahasuar me 2018). Megjithatë, pas 2020 ka pasur një rënie të ndjeshme, me buxhetin e 2023 duke qenë vetëm 23% e nivelit të 2018.

Tabela 11. Shpërndarja e investimeve kapitale në Obiliq sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018 – 2023

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Mazgit						1,028,000	1,028,000
Milloshvë	50,000	600,000				199,577	849,577
Breznicë			60,000			72,665	132,665
Lazarevë						85,000	85,000
Hade						10,000	10,000
Graboc i Epërm						5,000	5,000
Gjithsej							2,110,242

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbrasura nënkuptojnë se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet. Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Komuna e Obiliqit për investime kapitale ka pasur në dispozicion gjatë viteve 2018–2023 shumën mbi 28 milionë euro, ku 2.1 milionë euro (7.4%) u janë dedikuar zonave rurale dhe mbi 26 milionë euro (92.6%) zonave urbane.

Nga shpërndarja e buxhetit të komunës së Obiliqit sipas lokaliteteve, haset se disa lokalitete kanë përfituar shumë më tepër se të tjerat, ndërsa disa nuk kanë marrë asnjë investim të regjistruar gjatë periudhës 2018–2023. Obiliqit ka 19 lokalitete prej të cilave 68% (13) nuk kanë përfituar, 31% (6) kanë përfituar pjesërisht dhe asnjë lokalitet nuk rezulton të ketë përfituar vazhdimisht.

Lokaliteti që ka përfituar më së shumti është Mazgiti, me një investim prej në 1 milionë euro vetëm në vitin 2023. Kjo shumë e madhe tregon se ky lokalitet ka qenë fokus i zhvillimit të komunës. Pas tij vjen Milloshveva, me një total prej 650 mijë euro të investuara kryesisht në vitet 2018 dhe 2019, dhe një investim shtesë në 2023. Lazareva dhe Breznica gjithashtu kanë përfituar në mënyrë të konsiderueshme, me investime prej 85 mijë euro dhe 132 mijë euro.


Nga ana tjetër, shumë lokalitete si Babimoci, Bakshi, Çerkvena Vodica, Dobrosella, Hamidi, Kozarici, Krushevca, Lajthishta, Leshkoshiqi, Plemetini, Raskova, Siboci dhe Shipitulla nuk kanë asnjë investim të regjistruar gjatë kësaj periudhe.

Kjo gjendje ka mundur të shkaktohet edhe nga fakti se komuna paraqet një buxhet të përgjithësuar dhe nuk specifikohet se në cilat lokalitete po shpërndahet. Kjo praktikë mund të pengojë monitorimin efektiv të shpenzimeve publike dhe të vështirësojë vlerësimin e ndikimit real të investimeve në secilën zonë të komunës.


Komuna e Obiliqit gjatë vitit 2023 ka organizuar tri dëgjime buxhetore me qytetarë, ku në këto dëgjime kanë marrur pjesë 57 qytetarë të komunës. Raporti që ka paraqitur kjo komunë nga këto dëgjime nuk specifikon se cilat kanë qenë kërkesat e qytetarëve dhe sa prej tyre janë marrë parasysh nga komuna. Dy projektet me të kushtueshme në Obiliq gjatë periudhës 2018 – 2023 janë sheshi i qytetit si dhe nisja e projektit për lidhjen e qytetit në sistemin e kogjenerimit.

2.11 Komuna e Pejës

Buxheti i komunës së Pejës për investime kapitale ka treguar një trend të përgjithshëm rritës nga viti 2018 deri në 2023. Nga 2018 në 2019, pati një rritje të konsiderueshme prej 19% (1.2 milionë euro). Viti 2020 shënoi një rënie të lehtë prej 0.9% (minus 71 mijë euro), ndërsa 2021 pati një rënie të mëtejshme minimale prej 0.05%. Situata u përmirësua ndjeshëm në 2022 me një rritje të madhe prej afro 17% (1.3 milionë euro). Rritja më e madhe u pa në 2023, me një shtesë prej 30% (2.8 milionë euro) krahasuar me vitin paraprak. Në total, nga 2018 deri në 2023, buxheti u rrit me 79% (5.3 milionë euro), duke treguar një investim të shtuar në projekte kapitale në komunën e Pejës gjatë kësaj periudhe.

Figura 23. Buxheti për investime kapitale në Komunën e Pejës 2018 – 2023

Prioritetet e Komunës së Pejës gjatë gjashtë viteve (2018–2023) tregojnë se kjo komunë rëndësi i ka kushtuar infrastrukturës (rrugë, kanalizim, ujësjellës, parqe, ndriçim publik, trotuare, sheshe) si dhe përmirësimin të kushteve në fushën e kulturës.

Figura 24. Shpërndarja e buxhetit të kapitaleve sipas fushave kryesore në Komunën e Pejës përgjatë viteve 2018 – 2023

Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiare nga ana e kësaj komune.

Infrastruktura ka pasur rritjen më të madhe dhe të vazhdueshme. Nga 2.6 milionë euro në 2018, buxheti është rritur në 6.4 milionë euro në 2023, që përfaqëson një rritje prej afërsisht 143%. Kjo tregon se infrastruktura ka qenë prioriteti kryesor i komunës, me investime të mëdha që kanë vazhduar të rriten çdo vit.

Arsimi, në anën tjetër, ka pasur një trend të ndryshëm. Fillimisht pati një rritje të konsiderueshme nga 944 mijë euro në 2018 në 1.7 milionë euro në 2020 (një rritje prej 84%), por më pas pësoi një rënie të ndjeshme, duke arritur në 550 mijë euro në 2023. Kjo përfaqëson një rënie prej 68% nga piku i vitit 2020 dhe një rënie prej 42% krahasuar me vitin 2018.

Shëndetësia ka pasur luhatje të ndryshme. Pas një periudhe stagnimi dhe rënie nga 2018 deri në 2021, buxheti u rrit ndjeshëm në 2022 dhe 2023, duke arritur në 493 mijë euro, që është 110% më i lartë se në 2018. Kjo rritje e fundit mund të jetë një përgjigje ndaj sfidave shëndetësore me të cilat u përball vendi gjatë periudhës së pandemisë.

Kultura ka parë një rritje të konsiderueshme, veçanërisht në vitet e fundit. Nga 170 mijë euro në 2018, buxheti u rrit në mbi 1 milionë euro në 2023, një rritje masive prej 492%. Kjo tregon një fokus të ri në zhvillimin kulturor të komunës.

Bujqësia ka pasur një rritje të qëndrueshme por më të moderuar. Nga 400 mijë euro në 2018, buxheti u rrit në 880 mijë euro në 2023, një rritje prej 120%.

Tabela 12. Shpërndarja e investimeve kapitale në Pejë sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018 – 2023

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Gllaviçicë	1,370,000	1,450,000	180,000				3,000,000
Bogë	200,000					820,000	1,020,000
Baran				100,000	200,000	650,000	950,000
Zahaq			250,000	100,000		360,000	710,000
Leshan	200,000			100,000	150,000		450,000
Glllogjan	15,000					400,000	415,000
Drelaj				50,000		340,000	390,000
Vitomiricë	150,000			130,000		90,000	370,000
Haxhaj						320,000	320,000
Koshutan						320,000	320,000
Shkrel		100,000	205,000				305,000
Dubovë			30,000			250,000	280,000
Vranoc						280,000	280,000
Jabllanicë						260,000	260,000
Brestovik	10,000			120,000		100,000	230,000
Treboviq						200,000	200,000
Babiq						190,000	190,000
Buçan						190,000	190,000
Llabjan						190,000	190,000
Pishtan						190,000	190,000
Reka e Aliagës			150,000				150,000
Graboc						150,000	150,000
Jabllanicë e Vogël						130,000	130,000
Bellopojë						120,000	120,000
Bllagajë						100,000	100,000
Trestenik						100,000	100,000
Lutogllavë						90,000	90,000
Malaj			85,000				85,000
Novosellë	50,000	35,000					85,000
Dobërdol						70,000	70,000
Lipë						50,000	50,000
Radavc						50,000	50,000

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Gorazhdec			40,000				40,000
Shtupeç i Vogël						20,000	20,000
Gjithsej							11,500,000

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbrasura nënkupton se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet. Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Komuna e Pejës ka pasur në dispozicion (2018–2023) shumën mbi 52 milionë euro, prej të cilave 11 milionë euro (22%) janë investuar në zona rurale dhe 41 milionë euro (78%) në zona urbane.

Vlerësuar sipas shpërndarjes së kapitaleve nëpër lokalitete disa vendbanime kanë përfituar në mënyrë të konsiderueshme, ndërsa të tjerat, kanë marrë pak ose aspak fonde. Peja ka 68 lokalitete prej të cilave 51.5% (35) nuk kanë përfituar, 48.5% (33) kanë përfituar pjesërisht, ndërsa asnjë lokalitet nuk del të ketë përfituar vazhdimisht.

Vendbanimet që kanë përfituar më shumë përfshijnë Bogën me mbi 1 milionë euro, Baranin me 950 mijë euro dhe Zahaqin me 710 mijë euro. Këto lokalitete duket se kanë qenë prioritet për investime komunale gjatë viteve të fundit.

Në anën tjetër, ka një numër të konsiderueshëm të vendbanimeve që nuk kanë marrë asnjë fond gjatë periudhës 2018–2023, si Broliq, Brezhanik, Çallapek, Bregu i Zi, Aushkë, Dugaivë, Joshanicë, Klinçinë, Kosuriq, Kotradiq, Kërstoc, Kryshec, Kuqishtë, Lubeniq, Loxhë, Lozhanë, Shtupeli i Madh, Nabërgjan, Nakëllë, Ozdrim, Pepiq, Pavlan, Poçestë, Rashiç, Raushiç, Romunë, Rosulë, Ruhot, Sigë, Sverkë, Turjak, Jabllanica e Madhe, Vragoc, Zagërm dhe Zallapek.

Shumica e investimeve duket se janë përqendruar në vitin 2023, ku shumë vendbanime kanë marrë fonde për herë të parë ose kanë parë një rritje të konsiderueshme të investimeve.


Kjo gjendje ka mundur të shkaktohet edhe nga fakti se komuna paraqet një buxhet të përgjithësuar dhe nuk specifikohet se në cilat lokalitete po shpërndahet buxheti. Kjo praktikë mund të pengojë monitorimin efektiv të shpenzimeve publike dhe të vështirësojë vlerësimin e ndikimit real të investimeve në secilën zonë të komunës.

Komuna e Pejës gjatë vitit 2023 ka organizuar 12 dëgjime buxhetore me qytetarë, në të cilat kanë marrë pjesë gjithsej 299 qytetarë. Në këto dëgjime janë parashtruar 366 kërkesa ndaj komunës, prej të cilave 149 janë pranuar dhe përfshirë në verzionin final të buxhetit të komunës. Në procesverbalet e paraqitura dhe në raportin përmbledhës të konsultimeve publike, komuna nuk ka dhënë ndonjë shpjegim se pse janë refuzuar një numër i kërkesave të parashtruara nga qytetarët.


Projektet më të kushtueshme infrastrukturore në Komunën e Pejës gjatë periudhës 2018–2023 janë: ndërtimi i unazës së qytetit të Pejës, ndërtimi i sistemit të kanalizimit dhe ujësjellësit për fshatrat e rajonit të Rugovës.

2.12 Komuna e Suharekës

Buxheti i komunës së Suharekës për investime kapitale në fund të 2023 ka kaluar vlerën e 6 milionë eurove. Nga viti 2018 në 2019, pati një rritje të ndjeshme prej 33% (nga 4.1 milionë euro në 5.5 milionë euro). Megjithatë, në vitin 2020 pati një rënie prej 9%, pasuar nga një rënie tjetër e konsiderueshme prej 15% në vitin 2021 (në 4.2 milionë euro). Viti 2022 shënoi një rritje të lehtë prej 4.7% (në 4.4 milionë euro), ndërsa viti 2023 solli një rritje të konsiderueshme prej 36% (në mbi 6 milionë euro), duke arritur nivelin më të lartë në periudhën e analizuar. Buxheti në vitin 2023 ishte 46% më i lartë se në vitin 2018.

Figura 25. Buxheti për investime kapitale në Suharekë 2018 – 2023

Edhe të Suhareka infrastruktura ka qenë fusha me investimin më të lartë gjatë gjithë periudhës 2018 – 2023. Buxheti për infrastrukturë ka shfaqur luhatje, me një rritje të konsiderueshme prej 11% nga 2018 në 2019, pasuar nga një rënie e lehtë në 2020 dhe 2021. Viti 2022 shënoi pikun e investimeve me një rritje të jashtëzakonshme prej 33% krahasuar me 2021, ndërsa 2023 pa një rënie të lehtë prej 12%.

Figura 26. Shpërndarja e buxhetit të kapitaleve sipas fushave kryesore në Komunën e Suharekës përgjatë viteve 2018 – 2023

Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiare nga ana e kësaj komune.

Arsimi ka përjetuar luhatje të mëdha. Nga 2018 në 2019, pati një rritje të madhe prej 95%, por më pas pati një rënie të madhe në 2020 dhe asnjë investim në 2021. Viti 2022 shënoi një rikthim të investimeve, megjithëse më të ulëta se 2019, ndërsa 2023 pa një rënie të mëtejshme prej 45%.

Shëndetësia ka pasur një trend të paqëndrueshëm. Nga 2018 në 2019, pati një rritje të konsiderueshme prej 85%, pasuar me rënie në 2020 dhe 2021. Viti 2022 shënoi një rënie të konsiderueshme prej 94%, ndërsa 2023 pa një rritje të madhe, duke u kthyer pothuajse në nivelin e 2021.

Kultura nga 2018 në 2019, pati një rritje të jashtëzakonshme prej 161%, por në 2020 nuk pati fare investime. Viti 2021 pa një rikthim të investimeve, ndërsa 2022 shënoi një rënie të lehtë. Viti 2023 shënoi një rritje të konsiderueshme prej 299% krahasuar me 2022.

Bujqësia ka treguar një trend të ndryshueshëm. Nga 2018 në 2019, pati një rritje prej 35%, pasuar nga një rënie e lehtë në 2020 dhe një rritje të vogël në 2021. Viti 2022 shënoi një rënie të madhe prej 64%, ndërsa 2023 pa një rritje të jashtëzakonshme prej 386%.

Tabela 13. Shpërndarja e investimeve kapitale në Suharekë sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018- 2023

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Studençan	85,000	200,000	195,400	160,800	3,417	463,886	1,108,503
Bllacë		87,500	251,800	225,000	6,663	240,475	811,438
Peqan	55,000	61,769	25,500	425,000	14,285	63,888	645,442
Samodrezh		144,000	138,000	93,500	14,285	225,789	615,574
Budakovë	15,000	80,000	53,000	170,000	203,417	77,500	598,917
Gjinovc	35,000	127,000	70,500	125,000		176,666	534,166
Vraniq	55,000		59,500	70,000	49,430	164,250	398,180
Sallagrazhde		58,000	34,000	135,000		170,000	397,000
Reqan	12,000	199,000	39,000	60,000		77,500	387,500
Grejkoc	25,000	67,000	63,000	87,500	17,702	100,000	360,202
Duhël	15,000	28,000	21,500	65,000	3,417	200,416	333,333
Semetishtë	35,000	46,000	41,300	58,100	14,285	104,888	299,573
Sopijë	60,000		34,000	67,500		137,500	299,000
Bukosh		76,000	21,000	85,000	3,417	110,100	295,517
Mohlan	5,000		16,500	60,000	3,417	209,000	293,917
Sllapuzhan	45,000	29,000	41,000	32,000	20,948	115,475	283,423
Dubravë		85,000	26,000	125,000		20,000	256,000
Maçitevë	25,000			30,000		162,500	217,500
Gelanc	50,000	38,000	36,000	55,012		20,000	199,012
Krushica e Ultë	45,000		18,000	95,000	30,000	5,000	193,000
Nishor	65,000		18,500	35,000		73,750	192,250
Delloc	35,000		10,000	80,000	15,000	43,750	183,750
Tërnjë	15,000		45,400	50,500		62,110	173,010
Grejçec			71,000	30,000	30,000	40,000	171,000
Dobërodolan	45,000		50,000	40,020		28,500	163,520
Leshan			60,700	68,100	3,417	25,000	157,217
Kastërc	10,000		10,000	55,000	25,000	46,888	146,888
Savrovë		29,000	47,166	35,000		15,000	126,166
Papaz			18,500	25,000		81,587	125,087
Mushtishtë	30,000		28,000	40,000		25,000	123,000
Nepërbishtë	30,000		28,000	40,000		25,000	123,000
Krushicë e Epërme	20,000		10,000	20,000		42,500	92,500
Rashtan			19,400			70,554	89,954
Popolan	15,000	15,000	10,000	5,000	13,000	10,000	68,000
Vërshec	10,000		10,000	20,000	21,000	5,000	66,000
Dvoran	15,000		10,000	20,000		15,000	60,000
Luzhnicë	15,000		10,000	15,000		10,000	50,000
Staravuçin				2,500	15,285	16,000	33,785

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Çadrak					13,000	20,000	33,000
Gjithsej							10,705,324

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbrasura nënkupton se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet. Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Komuna e Suharekës gjatë periudhës 2018–2023 ka pasur në dispozicion afro 30 milionë euro, prej të cilave afro 11 milionë euro (37%) janë investuar në zona rurale dhe afro 19 milionë euro (63%) në zona urbane. Shpërndarja e buxhetit në komunën e Suharekës sipas lokaliteteve, për dallim nga komunat e tjera, ka qenë më e balancuar dhe më sistematike për gati pothuajse gjitha lokalitetet. Suhareka ka 39 lokalitete total, prej të cilave 13% (5) kanë përfituar pjesërisht, dhe 87% (34) kanë përfituar vazhdimisht.

Studençani del si përfituesi më i madh, me një total prej 1.1 milionë euro, duke treguar një investim të qëndrueshëm dhe të lartë përgjatë viteve. Mushtishti gjithashtu ka marrë një shumë të konsiderueshme prej 903 mijë euro dhe Bllaca prej 971 mijë euro.

Në anën tjetër, disa lokalitete kanë marrë fonde minimale. Për shembull, Dvoran ka marrë vetëm 60 mijë euro gjatë gjithë periudhës, ndërsa Luzhinica ka përfituar 50 mijë euro. Vërsheci, me 46 mijë euro, dhe Staravuçini, me vetëm 33 mijë euro, janë ndër vendbanimet me më pak fonde të alokuara.


Disa vendbanime nuk kanë marrë fonde në vite të caktuara, siç është rasti i Çadrakut, i cili ka filluar të marrë fonde vetëm në vitet e fundit. Suhareka gjatë vitit 2023 ka organizuar katër dëgjime buxhetore me qytetarë, ku prezentë kanë qenë 147 qytetarë dhe janë parashtruar 40 kërkesa, nga të cilat vetëm shtatë janë pranuar nga ana e komunës, komuna nuk i ka bërë të ditura në raportin përmbledhës dhe procesverbalet e konsultimeve publike arsyjet e refuzimit të kërkesave.

Projektet më të kushtueshme infrastrukturore në Komunën e Suharekës gjatë periudhës 2018–2023 janë ndërtimi i rrugës Suharekë–Mushtisht, ndërtimi i palestrës sportive "17 Shkurti" si dhe ndërtimi i impiantit për trajtimin e ujërave të zeza i cili akoma nuk është finalizuar.

2.13 Komuna e Vitisë


Buxheti i komunës së Vitisë për investime kapitale ka tejkaluar vlerën e 4 milionë eurove. Nga 2018 në 2019, pati një rënie të lehtë prej 4%. Viti 2020 shënoi rënien më të madhe, me 22% krahasuar me vitin paraprak, për shkak të pandemisë COVID-19. Megjithatë, nga 2020 e tutje, buxheti ka shënuar rritje të vazhdueshme. Viti 2021 pa një rritje të konsiderueshme prej 47% krahasuar me 2020. Rritja vazhdoi me 10% në 2022 dhe një rritje të jashtëzakonshme prej 51% në 2023, duke arritur nivelin më të lartë të periudhës 2018–2023.

Figura 27. Buxheti për investime kapitale Komunën e Vitisë 2018 – 2023



Infrastruktura si fushë ka pasur rëndësinë më të madhe dhe rritjen më të konsiderueshme të buxhetit. Nga 1.9 milionë euro në vitin 2018, buxheti për infrastrukturë u rrit në 3.5 milionë euro në vitin 2023, që përfaqëson një rritje prej rreth 82%. Vlen të theksohet se pati një rënie të vogël në 2019 dhe një rënie më të madhe në 2020 (për shkak të pandemisë), por pastaj pati një rritje të shpejtë dhe të vazhdueshme nga 2021 e tutje.

Figura 28. Shpërndarja e buxhetit të kapitaleve sipas fushave kryesore në Komunën e Vitisë përgjatë viteve 2018 – 2023



Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiarë nga ana e kësaj komune.

Buxheti për arsim ka qendruar relativisht i qëndrueshëm nga 2018 deri në 2022, me një vlerë prej 110 mijë euro deri 120 mijë euro. Megjithatë, në vitin 2023 pati një rritje të konsiderueshme në 250 mijë euro që përfaqëson një rritje prej 127% krahasuar me vitin e mëparshëm.

Buxheti për shëndetësi nga 156 mijë euro në 2018, pati një rënie të lehtë në 2019, pastaj një rënie të konsiderueshme në 2020 (70 mijë për shkak të rialokimit të fondeve gjatë pandemisë). Në 2021 pati një rritje të konsiderueshme në 150 mijë euro, por pasuar nga rënie të lehta në 2022 dhe 2023. Krahasuar me 2018, buxheti i 2023 për shëndetësi është rreth 29% më i ulët. Komuna e Vitisë nuk ka publikuar të dhëna gjatë vitit 2023 dhe 2022 lidhur me mbajtjen ose jo të konsultimeve buxhetore me qytetarë.

Tabela 14. Shpërndarja e investimeve kapitale në Viti sipas lokaliteteve (pa i përfshirë lagjet ose zonat e qytetit) për vitet 2018- 2023

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Sllatinë				200,000	90,000	272,151	562,151
Pozharan	50,000		130,000	32,500		156,707	369,207
Letnicë					221,486	40,000	261,486
Beguncë						205,110	205,110
Drobesh						180,702	180,702
Tërpezë			83,050	26,666		59,285	169,001
Radivojcë						146,914	146,914
Smirë			63,050	26,666		49,313	139,029
Lubishtë						135,396	135,396
Remnik						132,082	132,082
Ramjani						127,415	127,415

Vendbanimet	2018	2019	2020	2021	2022	2023	Gjithsej shuma (€)
Sadovinë e Çerkezëve						124,802	124,802
Stublla e Poshtme		95,000				29,000	124,000
Gushicë						120,027	120,027
Vërban						114,313	114,313
Devajë						99,722	99,722
Novosellë						95,000	95,000
Sadovinë e Jerlive						93,533	93,533
Gjylekar						81,111	81,111
Ballancë						79,007	79,007
Buzovik				32,500		45,000	77,500
Gërmovë						71,813	71,813
Kabash						70,813	70,813
Stubëll e Epërme						65,714	65,714
Ramnishtë						60,424	60,424
Budrikë e Epërme						56,416	56,416
Zhiti						51,785	51,785
Tërstenik						47,507	47,507
Podgorc						39,285	39,285
Debellde						15,714	15,714
Gjithsej							3,916,979

Sqarim: Rubrikat e mbetura të zbrasura nënkuptojnë se atë vit në atë lokalitet nuk ka pasur projekte të planifikuara në buxhet. Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në Ligjin për ndarjen e kufijëve administrativë të komunave.

Gjatë periudhës 2018–2023, Komuna e Vitisë ka pasur në dispozicion 15 milionë euro për investime kapitale, prej të cilave afro 4 milionë euro (26%) janë shpenzuar në zona rurale dhe mbi 11 milionë euro (74%) në zona urbane.

Vlerësuar sipas shpërndarjes së buxhetit të kapitaleve sipas vendbanimeve, vërehet një shpërndarje jo e barabartë e buxhetit. Disa vendbanime kanë përfituar dukshëm më shumë se të tjerat, ndërsa disa nuk kanë marrë asnjë financim gjatë periudhës 2018–2023. Komuna e Vitisë ka 36 lokalitete prej cilave rezulton se 17% (6) nuk kanë përfituar, 83% (30) kanë përfituar pjesërisht, dhe nuk ka asnjë lokalitet që ka përfituar vazhdimisht.

Lokalitetet që kanë përfituar më së shumti përfshijnë Sllatinën me 562 mijë euro, Pozharan me 369 mijë euro, dhe Letnicën me 261 mijë euro. Këto shifra tregojnë një fokus të konsiderueshëm të investimeve në këto zona. Në anën tjetër, disa vendbanime kanë marrë financim relativisht të kënaqshëm, si Beguncë me 205 mijë euro, Drobesh me 180 mijë euro, dhe Radivojcë me 146 mijë euro. Këto shuma, megjithëse të konsiderueshme, janë dukshëm më të ulëta se ato të vendeve kryesuese.

Por disa lokalitete nuk kanë marrë asnjë financim gjatë periudhës së raportuar, duke përfshirë Çiflak, Mjak, Shashare, Godenci i Madh, Vërnakollë dhe Vërnez.

Gjithashtu, vërehet se shumica e financimeve janë bërë në vitin 2023, me shumë pak ose aspak investime në vitet e mëparshme për shumicën e vendbanimeve. Kjo gjendje ka mundur të


shkaktohet edhe nga fakti se komuna ka paraqitur deri në vitin 2022 një buxhet të përgjithësuar dhe nuk ka specifikuar se në cilat lokalitete po shpërndahet buxheti i kapitaleve.

Projektet më të kushtueshme infrastrukturore në Komunën e Vitisë gjatë periudhës 2018-2023 janë ndërtimi i rrugës Viti-Letnicë, ndërtimi i shkollës së mesme teknike si dhe ndërtimi i objektit të ri shkollor për arsimin profesional.

2.14 Komuna e Junikut

Buxheti i komunës së Junikut për investime kapitale është me i ulët në mesin e këtyre 15 komunave të përfshira në këtë raport. Në vitin 2018 buxheti ishte 426 mijë euro duke pësuar një rënie të lehtë prej 2% në vitin 2019 me 417 mijë euro. Viti 2020 shënoi një rënie të madhe prej 45% në gjithsej 226 mijë euro, pasuar nga një rënie edhe më e thellë në 2021 në gjithsej 79 mijë euro, që përfaqëson një ulje prej 65% krahasuar me vitin paraprak. Megjithatë, në 2022 pati një rritje të konsiderueshme prej 171% me një buxhet prej gjithsej 215 mijë euro dhe trendi pozitiv vazhdoi në 2023 me një rritje shtesë prej afro 77%, duke arritur në 380 mijë euro. Pavarësisht rritjes së fundit, buxheti i viti 2023 ende mbetet afro 11% më i ulët se ai i vitit 2018.

Figura 29. Buxheti për investime kapitale në Komunën e Junikut 2018 – 2023




Investimet kapitale në komunën e Junikut nga viti 2018 deri në 2023 tregojnë një trend të luhatshëm në shpërndarjen e fondeve nëpër fusha të ndryshme. Infrastruktura ka marrë pjesën më të madhe të investimeve, me një mesatare prej 135 mijë euro në vit, duke arritur pikun në 2018 me 273 mijë euro. Megjithatë, ka pasur një rënie të ndjeshme në 2021 me vetëm 41 mijë euro, pasuar nga një rimëkëmbje graduale.

Fusha e ekonomisë ka shfaqur luhatje të mëdha, me investimin më të lartë prej 145 mijë euro në 2019, por duke rënë ndjeshëm në 10 mijë euro në 2022. Kjo paraqet një diferencë prej 93% midis vitit më të lartë dhe më të ulët të investimeve në këtë fushë.

Shërbimet publike kanë parë një rritje të konsiderueshme në 2019 dhe 2023, me 101 mijë euro dhe 96 mijë euro përkatësisht, ndërsa vitet e tjera kanë qenë relativisht të vogla me një mesatare prej 33 mijë euro. Arsimi ka marrë investimet më të ulëta, por më të qëndrueshme, me një rritje graduale nga 10 mijë euro në 2018 në 15 mijë euro në 2023, që paraqet një rritje prej 50% gjatë kësaj periudhe. Në përgjithësi, viti 2019 shënoi pikun e investimeve totale me 417 mijë euro, ndërsa 2022 ishte viti me investimet më të ulëta.

Figura 30. Shpërndarja e buxhetit të kapitaleve sipas fushave kryesore në Komunën e Junikut përgjatë viteve 2018 – 2023




Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiarë nga ana e kësaj komune.

Komuna e Junikut karakterizohet nga një strukturë administrative e veçantë, duke përfshirë vetëm dy lokalitete kryesore. Ky konfigurim unik paraqet sfida në paraqitjen e detajuar të shpërndarjes së buxhetit sipas zonave specifike. Gjatë procesit të hartimit të buxhetit vjetor, komuna nuk specifikon shpenzimet sipas lagjeve apo zonave të veçanta, por fokusohet në kategori të përgjithshme të shpenzimeve. Komuna e Junikut gjatë vitit 2023 ka organizuar tri dëgjime buxhetore me qytetarë, ku prezentë evidentohen të kenë qenë 43 qytetarë, që kanë parashtruar 33 kërkesa, prej të cilave 17 janë marrë parasysh gjatë hartimit të buxhetit. Refuzimi i kërkesave të tjera ka ardhur kryesisht për dy arsye: e para, mungesa e kapacitetit buxhetor të komunës për t'i mbuluar projektet (propozimet) e tilla dhe se disa kërkesa, sikurse për asfaltim të rrugëve private, nuk janë në kompetencat e komunës.

2.15 Komuna e Graçanicës


Buxheti i komunës së Graçanicës për investime kapitale ka pësuar ndryshime të konsiderueshme nga viti 2018 deri në 2023. Rritja më e madhe u shënua nga 2018 në 2019, me një rritje prej 132% (nga 3.5 milionë euro në 8.2 milionë euro). Megjithatë, viti 2020 shënoi një rënie të ndjeshme prej 38% krahasuar me 2019. Trendi i rënies vazhdoi në 2021 dhe 2022, me ulje përkatësisht prej 43% dhe 14%. Viti 2023 tregoi një përmirësim të lehtë me një rritje prej 18% krahasuar me 2022, por ende mbetet nën nivelin e vitit 2018.

Figura 31. Buxheti për investime kapitale në Komunën e Graçanicës 2018 – 2023



Shpërndarja e kapitaleve sipas fushave për vitet 2018–2023, tregon se infrastruktura ka qenë fusha me buxhetin më të lartë gjatë gjithë periudhës, duke treguar një fokus të vazhdueshëm në zhvillimin e infrastrukturës komunale. Megjithatë, ka pasur luhatje të konsiderueshme, me një rritje të madhe në vitin 2020 (45% më shumë se në 2019) dhe një rënie të ndjeshme në 2021 (47% më pak se në 2020).

Figura 32. Shpërndarja e buxhetit të kapitaleve sipas fushave kryesore në Komunën e Graçanicës përgjatë viteve 2018 – 2023



Sqarim: Janë paraqitur vetëm fushat dhe shumat kryesore të financiarë nga ana e kësaj komune.

Arsimi ka qenë fusha e dytë më e financuar, por ka pësuar një rënie të konsiderueshme nga viti 2019 në 2020 (34% ulje) dhe ka mbetur relativisht e ulët që atëherë.

Shëndetësia ka parë një rritje të konsiderueshme në vitin 2020 (129% më shumë se në 2019), si reagim ndaj pandemisë COVID-19. Megjithatë, buxheti i shëndetësisë ka rënë ndjeshëm në vitet pasuese, duke u stabilizuar në një nivel më të ulët se para pandemisë. Kultura ka parë luhatje të mëdha, me zero financim në 2018 dhe 2023, por me një rritje të konsiderueshme në 2019 dhe 2020. Kjo mund të tregojë projekte specifike kulturore që kanë marrë financim të përkohshëm. Bujqësia ka marrë financim vetëm në vitet 2020 dhe 2021, duke sugjeruar një fokus të përkohshëm në këtë sektor.

Gjatë procesit të hartimit të buxhetit vjetor, komuna nuk specifikon shpenzimet sipas lagjeve apo zonave të veçanta, por fokusohet në kategori të përgjithshme të shpenzimeve nisur nga projektet dhe jo nga lokalitetet. Përveq kësaj kjo komunë nuk ka asnjë dokument të publikuar që tregon se ndjek konsultimin me qytetarë gjatë fazës së hartimit të buxhetit.

3. Sa përfshihen në buxhetin e investimeve kapitale lokalitetet e banuara nga komunitetet jo shumicë

Investimet kapitale në lokalitetet e banuara nga komunitetet jo shumicë në Kosovë janë thelbësore për zhvillimin dhe aplikimin e politikave gjithëpërfshirëse. Së pari, investimet në infrastrukturë, arsim, shëndetësi dhe shërbime publike në këto zona ndihmojnë në reduktimin e pabarazive sociale dhe ekonomike midis komuniteteve të ndryshme. Kjo kontribuon në krijimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë, ku të gjithë qytetarët, pavarësisht nga përkatësia etnike, kanë qasje të barabartë në mundësi dhe shërbime.

Përveç kësaj, mbështetja e komunave për këto lokalitete demonstroi angazhimin e shtetit për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e minoriteteve. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e Kosovës, ku ndërtimi i besimit ndërmjet komuniteteve të ndryshme është kritik për stabilitetin dhe prosperitetin afatgjatë të vendit.

Tabela 15. Investimet kapitale nga komunat në lokalitetet e banuara me minoritete gjatë periudhës 2018 – 2023

Komunat	Lokalitetet të banuara kryesisht me minoritete					Investimet nga komuna 2018 – 2023 (Euro)
Drenas	×	×	×	×	×	
Dragash	Brod	Restelic	Dikancë	Kërstec	Krushevë	2,483,843
Kaçanik	×	×	×	×	×	
Pejë	Brestovik	Vitomiricë	×	×	×	600,000
Kamenicë	Moçar	Strezoc	Vaganesh	×	×	43,000
Obiliqi	Cërkvena Vodiç	Plemetin	×	×	×	0
Suharekë	Gelancë	×	×	×	×	199,000
Rahovec	Hoçë e Madhe	Dobidol	×	×	×	210,000
Klinë	Rudicë	×	×	×	×	195,000
Viti	×	×	×	×	×	
Ferizaj	Pleshinë	Papaz	×	×	×	152,000
Podujevë	×	×	×	×	×	
Prizren	Gërçar Manastiricë	Gornjasellë Nebregoshtë	Jabllanicë Reçan	Lubinjë Skorobishtë	Lubizhdë Sredskë	1,029,000

Sqarim: Rubrikat x nënkupton se atë vit në atë lokalitet nuk është hasur buxhetim gjinor.

Burimi: Ndarjet buxhetore të komunës për investime kapitale sipas viteve përkatëse të paraqitura në tabelë. Lokalitetet janë vendosur bazuar në statistikat e popullsisë të vitit 2021 të ASK-së.

Nga komunat e vlerësuara del se komuna e Dragashit ka numrin më të madh të lokaliteteve të banuara kryesisht nga komunitetet jo shumicë, duke përfshirë Brodin, Restelicën, Dikancën, Kërstecin dhe Krushevën. Kjo komunë gjithashtu qëndron në krye për sa i përket investimeve, me një shumë prej 2.4 milionë euro të investuara në këto zona gjatë periudhës së përmendur.

Prizreni, një tjetër komunë me diversitet të lartë, ka gjithashtu një numër të konsiderueshëm të lokaliteteve minoritare, duke përfshirë Gërçar, Manastiricë, Gornjasellë, Nebregoshtë,

Jabllanicë, Reçan, Lubinjë, Skorobishtë, Lubizhdë dhe Sredskë. Kjo komunë ka investuar mbi 1 milionë euro, duke e vendosur atë në vendin e dytë për sa i përket investimeve.

Në anën tjetër, disa komuna si Drenasi, Kaçaniku, Vitia dhe Podujeva nuk kanë të dhëna specifike për lokalitetet e banuara nga komunitetet jo shumicë ose investimet e bëra. Kjo mund të tregojë ose mungesë të komuniteteve të konsiderueshme jo-shumicë në këto zona, ose mungesë vullneti të disa komuniteteve jo shumicë për t'u regjistruar gjatë fazës së regjistrimit të popullsisë.

Komuna e Obiliqit, megjithëse ka dy lokalitete të identifikuar (Cërkvëna Vodiq dhe Plemetin), nuk ka raportuar asnjë investim gjatë kësaj periudhe.

4. Ndërlidhja e investimeve kapitale me premtimet elektorale

Krahasimi dhe vlerësimi i tri mandateve (12 viteve) të qeverisjes lokale në Kosovë nxjerr në pah se numri i premtimeve në fushën e infrastrukturës ka ardhur duke rënë, megjithatë edhe shkalla e përmbushjes së tyre ka rezultuar me rënie. Kështu gjatë mandatit 2013–2017, u dhanë 333 premtime në fushën e infrastrukturës, nga të cilat u përmbushën 221, duke shënuar një shkallë përmbushjeje prej 66%.

Mandati tjetër, 2017–2021, shënoi një ulje të lehtë në numrin e premtimeve në infrastrukturë (rrugë, trotuare, rrjeti i kanalizimit, ujësjellësit, impiante, ndriçim publik, parqe) me 274 premtime, por me një rritje të shkallës së përmbushjes në 67%, duke realizuar 184 premtime.

Për mandatin aktual 2021–2025, janë dhënë 199 premtime, deri në qershor 2024 me vetëm 44 të përmbushura, që përfaqëson një shkallë përmbushjeje prej 22%. Kjo vjen edhe përkundër që në strukturën e buxheteve komunale në fushën e kapitaleve, shpenzimet për infrastrukturë marrin përqindjen më të madhe të investimeve. Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelën më poshtë, vërehet ecuri e ndadalshme në realizimin e premtimeve infrastrukturore në 14 komunat e Kosovës. Nga totali prej 95 premtimeve të monitoruara në 14 komuna, 30 premtime ose 31.6% ende nuk kanë filluar të realizuar. Ndërkaq, 16 premtime janë në fazën e fillimit.

Po ashtu, 27 premtime janë gjysmë të përmbushura dhe 22 janë realizuar plotësisht, që së bashku këto të fundit përbëjnë 51.6% të totalit të premtimeve. Megjithatë, ekzistojnë dallime të konsiderueshme mes komunave. Për shembull, Komuna e Kaçanikut ka numrin më të lartë të premtimeve të përcaktuara (14), ndërsa disa komuna si Juniku, Rahoveci dhe Vitia kanë treguar progres më të mirë. Megjithatë, ritmi i përgjithshëm i implementimit mbetet sfidues, duke pasur parasysh që vetëm 23% e premtimeve janë realizuar plotësisht deri në qershor 2024.


Tabela 16. Shkalla e realizimit të premtimeve në 14 komuna në fushën e infrastrukturës deri në qershor 2024

Sqarim: Në Komunën e Graçanicës nuk ka pasur premtime të shpalosura gjatë fushatës së kaluar zgjedhore.

	Nuk kanë filluar	Të filluara	Gjysmë të përmbushura	Të përmbushura
Agim Aliu (Ferizaj)	4	2	5	2
Bali Muharremaj (Suharekë)	1			
Besim Ilazi (Kaçanik)	14	2	6	2
Bexhet Xheladini (Dragash)	2		1	4
Ferit Idrizi (Junik)	1			3
Gazmend Muhaxheri (Pejë)	1	1	3	1

	Nuk kanë filluar	Të filluara	Gjysmë të përbushura	Të përbushura
Ramiz Lladrovci (Drenas)	1	1	1	2
Ruzhdi Shehu (Junik)			1	1
Shaqir Totaj (Prizren)	1	2		2
Shpejtim Bulliqi (Podujevë)	1	1	2	1
Smajl Latifi (Rahovec)			2	
Sokol Haliti (Viti)		2	1	1
Xhafer Gashi (Obiliq)	2	2	3	2
Zenun Elezaj (Klinë)	2	3	3	2
Totali	30	16	27	22

Figura 33. Numri i përgjithshëm i premtimeve elektorale dhe ndarja me premtimet në fushën e infrastrukturës




Burimi: Instituti GAP

Nga gjithsej 1816 premtime të dhëna për mandatin 2021-2025 deri në muajin qershor 2024, 765 premtime (42%) janë të përbushura plotësisht, 304 premtime (17%) janë gjysmë të përbushura, 326 premtime (18%) premtime janë të të filluara, 421 premtime (23%) nuk kanë filluar ende. Ndërkaq, tek premtimet sipas fushave, tek infrastruktura janë pëmbushur 20% e premtimeve; tek arsimit 54%; shërbimet publike 25%; ekonomia 52%; shëndetësia 66%; bujqësia 50%; administrata 66%; mbrojtja sociale 50%; urbanizmi 27%; dhe sporti 36%.

Një faktor kyç që shpjegon shpenzimet e larta në infrastrukturë dhe shkallën jo të kënaqshme të përbushjes së premtimeve është mungesa e një ndërlidhjeje të qartë mes investimeve kapitale dhe premtimeve elektorale. Kjo mungesë ndërlidhjeje vjen për shkak të planifikimit të pakoordinuar, për faktin se shpesh planet për investime kapitale hartohen pa marrë parasysh premtimet specifike të bëra gjatë fushatave zgjedhore. Faktor shtesë është edhe fakti se udhëheqësit lokal mund të vendosin të investojnë në projekte që nuk ishin pjesë e premtimeve elektorale, por që konsiderohen të nevojshme për komunitetet dhe lokalitetet.

Figura 34. Numri i premtimeve në infrastrukturë dhe numri i premtimeve të përmbushura në infrastrukturë gjatë mandateve



Burimi: Instituti GAP

Nga figura me lart vërehet një trend në rënie i numrit të premtimeve të dhëna në fushën e infrastrukturës nga mandati në mandat, si dhe nivele të ndryshme të realizimit të tyre. Në mandatin 2013–2017, nga 339 premtime të dhëna në infrastrukturë janë realizuar 211, që përbën një shkallë realizimi prej 62%. Kjo paraqet një performancë relativisht të mirë në aspektin e përmbushjes së premtimeve gjatë atij mandati në fushën e infrastrukturës.

Në mandatin 2017–2021, numri i premtimeve në fushën e infrastrukturës ka rënë në 274, prej të cilave janë realizuar 184, duke arritur një shkallë realizimi prej 67%. Pavarësisht numrit më të vogël të premtimeve, ky mandat ka treguar një përqindje më të lartë të realizimit krahasuar me mandatin paraprak.

Edhe mandati aktual 2021–2025 shfaq një rënie të mëtijshme në numrin e premtimeve në fushën e infrastrukturës, me gjithsej 199 të tilla, prej të cilave deri në qershor 2024 janë realizuar vetëm 44 (22.1%). Megjithatë, duhet marrë parasysh që ky mandat ende nuk ka përfunduar dhe ka ende kohë për realizimin e premtimeve të mbetura. Pamundësia apo vështirësia e komunave në përmbushjen e premtimeve në infrastrukturë vije për shkak të disa faktorëve, sikurse mos planifikimi i duhur i projekteve investuese, luhatjet e mëdha dhe të shpeshta të çmimeve në treg të materialeve që përdoren dhe pastaj pamundësia e kompanive për t'i përmbushur kontratat publike. Po ashtu, faktorë shtesë që ndikojnë negativisht në ecurinë e punëve infrastrukturore rezultojnë të jenë edhe mungesa e resurseve teknike dhe profesionale e operatorëve privatë që kontraktojnë punë publike, problemet pronësore, dhe problemet buxhetore nga kontratat kolektive.

5. Buxheti i përgjegjshëm gjinor në 15 komuna

Buxheti gjinor në komunat e Kosovës është thelbësor për të promovuar barazinë gjinore dhe zhvillimin e qëndrueshëm lokal. Kjo qasje siguron që burimet financiare të shpërndahen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë mes burrave dhe grave, duke adresuar nevojat specifike të të dy gjinive. Përmes buxhetimit gjinor, komunat mund të identifikojnë dhe të trajtojnë pabarazitë ekzistuese, të përmirësojnë cilësinë e shërbimeve publike për të gjithë qytetarët, dhe të rrisin pjesëmarrjen e grave në vendimmarrjen lokale.

Ndryshe, zberthimi konceptual dhe ligjor i të kuptuarit të buxhetimit i përgjegjshëm gjinor nënkupton një qasje që siguron që nevojat dhe interesat e grave dhe burrave në procesin e planifikimit dhe shpërndarjes së buxhetit publik, duke marrë parasysh se perspektivat dhe nevojat gjinore mund të jenë të ndryshme. Buxheti gjinor në nivelin komunal në Kosovë është edhe obligim ligjor. Kjo praktikë ndihmon në zbatimin efektiv të politikave dhe strategjive kombëtare për barazinë gjinore, duke kontribuar në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe social të vendit. Gjithashtu,

buxhetimi gjinor rrit transparencën dhe llogaridhënien në qeverisjen lokale, duke forcuar besimin e qytetarëve në institucionet publike dhe duke promovuar një shoqëri të barabartë.

Tabela 17. Sa e përfshijnë buxhetimin gjinor 15 komunat në buxhetet e tyre

Komunat	Publikimi i dokumenteve të buxhetimit të pergjegjshëm gjinor			
	2020	2021	2022	2023
Drenas	✓	✓	✓	✗
Dragash	✓	✓	✓	✗
Kaçanik	✓	✓	✓	✓
Pejë	✗	✗	✗	✗
Kamenicë	✓	✗	✓	✗
Obiliqi	✓	✓	✓	✗
Suharekë	✓	✗	✓	✓
Rahovec	✗	✗	✓	✓
Klinë	✗	✗	✓	✗
Viti	✓	✗	✗	✗
Ferizaj	✓	✗	✓	✓
Podujevë	✓	✓	✓	✓
Prizren	✗	✗	✗	✗
Junik	✗	✓	✓	✓
Graçanicë	✗	✗	✓	✓

Burimi: Instituti GAP raporti i Indeksit të transparencës buxhetore

Bazuar në të dhënat e paraqitura në tabelë, mund të vërehet një trend i ndryshëm në publikimin e dokumenteve (dokumente të vleresuara janë buxheti i miratuar, dokumentet nga procesverbalet e konsultimeve publike dhe Kornizës Afatmesme Buxhetore) të buxhetimit të përgjegjshëm gjinor nga komunat e ndryshme të Kosovës gjatë periudhës 2020–2023. Disa komuna si Kaçaniku dhe Podujeva, kanë qenë konsistente në publikimin e këtyre dokumenteve për të gjitha vitet. Ndërkaq, Peja dhe Prizreni nuk kanë publikuar asnjë dokument gjatë kësaj periudhe, si dhe komuna të tjera si Rahoveci dhe Juniku kanë filluar publikimin më vonë dhe kanë vazhduar rregullisht. Vlerësimi i përgjithshëm tregon një përmirësim gradual, por jo të njejtë në të gjitha komunat, bazuar në Kornizën Afatmesme të Buxhetit., në publikimin e këtyre dokumenteve.

6. Procesi i konsultimit me qytetarë në fazën e hartimit të buxhetit (2018 – 2023)

Konsultimi i qytetarëve në proceset e planifikimit buxhetor në komuna është një element thelbësor i demokracisë lokale dhe dëshmi e ndjekjes së parimit të qeverisjes së mirë. Kjo praktikë siguron që vendimet financiare të komunave të reflektojnë nevojat reale dhe prioritetet e qytetarëve. Përmes konsultimeve publike, qytetarët kanë mundësinë të shprehin propozimet e tyre për projektet kapitale, shërbimet publike dhe investimet e ndryshme që ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së tyre.

Kjo qasje, jo vetëm që rrit transparencën dhe llogaridhënien e institucioneve lokale, por edhe forcon besimin dhe përkushtimin e qytetarëve në qeverisjen lokale. Gjithashtu, përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje ndihmon në identifikimin e problemeve që mund të jenë të panjohura për zyrtarët komunalë dhe mundëson një shpërndarje më të drejtë dhe efektive të burimeve financiare. Kjo praktikë demokratike është veçanërisht e rëndësishme në kontekstin e Kosovës, ku forcimi i institucioneve lokale dhe rritja e besimit të qytetarëve në to mbeten prioritetet kyçe për zhvillimin e qëndrueshëm.

Konsultimi i qytetarëve, përveç një parim që dëshmon qeverisjen e mirë dhe të hapur, është edhe obligim ligjor. Ky proces në Kosovë, shikuar nga prizmi i qeverisjes lokale është i rregulluar me Kushtetuten e Kosovës (neni 45) dhe me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale (neni 68, 69 dhe neni 73) – nene këto që saktësojnë dhe rregullojnë procesin dhe procedurat e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje dhe informimin e tyre lidhur me politikat publike. Përveç ligjit bazë të komunave, edhe Udhëzimi Administrativ për administratë të hapur në komunë i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) i vitit 2023 u jep shpjegim dhe përmbajtje konsultimeve dhe përfaqësimit të qytetarëve në vendimarrjen lokale.

Bazuar në këtë udhëzim administrativ, komunat përveç që e kanë obligim zhvillimin e konsultimeve publike me qytetarë, ato duhet të publikojnë në ueb faqet e tyre informata lidhur me numrin e pjesëmarrësve dhe gjininë e tyre, kërkesat ose ankesat që janë paraqitur dhe detaje të tjera nga ecuria e zhvillimit të konsultimeve, përfshirë llogaridhënien e komunave dhe mënyren e organizimit teknik të proceseve të konsultimit.

Një vit pas nisjes së kësaj praktike (2019), Kosova u përball me pandeminë COVID-19 dhe ishin në fuqi ndalesat për tubime me qytetarë, të cilat në një formë ose tjetrën kanë zgjatur edhe gjatë vitit 2021. Efekt negativ në këtë mes është paraqitur edhe mungesa e funksionimit të rregullt të ueb faqeve zyrtare të komunave, disa prej të cilave e kanë pasur të pamundur teknikisht që t'i ngarkojnë dokumentet (raportet) për të treguar lidhur me numrin dhe ecurinë e konsultimeve publike në komunat respektive.

Tabela 18. Numri i konsultimeve publike të mbajtura në 11 komuna, pjesëmarrësve, kërkesave të parashtruara dhe numri i kërkesave të pranuar nga komuna (konsultime të mbajtura në vitin 2023 për buxhetin 2024)

	Drenas	Pejë	Kamenicë	Obiliq	Suharekë	Rahovec	Klinë	Dragash	Junik	Ferizaj	Podujevë
Numri i dëgjimeve të mbajtura	8	12	29	3	4	11	7	8	3	9	3
Numri i pjesëmarrësve	281	299	663	57	147	153	88	201	43	226	37
Numri i propozimeve	92	366	352	/	40	144	41	55	33	171	91
Numri i propozimeve të përfshira në buxhetin e vitit përkatës	64	149	216	/	7	48	23	43	17	136	53
Përqindja e kërkesave të pranuar	69%	40%	61%	/	17%	33%	56%	78 %	51%	79%	58%
Totali i kërkesave të parashtruara											1,385
Totali i kërkesave të pranuar											756 (55%)


Bazuar në të dhënat e paraqitura për vitin 2023, konstatohet se prezenca e qytetarëve në konsultimet buxhetore vazhdon të mbetet problem i veçantë. Ndërkaq, pozitiv është fakti se në shumë komuna, shumica e kërkesave që qytetarët kanë parashtruar janë marrë parasysh nga ana e komunave.

Në mesin e këtyre 11 komunave që kanë publikuar raportet e konsultimeve publike lidhur me buxhetin, Komuna e Kamenicës del të jetë më aktive me 29 dëgjime të mbajtura dhe 663 pjesëmarrës, që tregojnë një mesatare prej 23 pjesëmarrësve për dëgjim. Kjo komunë gjithashtu ka pranuar 352 propozime, prej të cilave 216 (61%) janë përfshirë në buxhet.

Në anën tjetër, komuna e Pejës, me 12 dëgjime dhe 299 pjesëmarrës, ka pranuar numrin më të madh të propozimeve (366), por ka përfshirë 149 (41%) në buxhet. Komunitat më të vogla si Juniku dhe Obiliqi kanë pasur aktivitetin më të ulët në këtë aspekt, me nga 3 dëgjime secila. Në Obiliq, ku nuk ka të dhëna për propozimet e pranuar apo të realizuara, gjë e cila ka ardhur nga fakti se raporti i publikuar nga komuna nuk ka qenë i plotë, tregohet vetëm për numrin e konsultimeve të organizuara dhe numrin e pjesëmarrësve – por jo edhe për kërkesat e parashtruara dhe ato të pranuar nga komuna.

Dragashi, Drenasi dhe Ferizaj dalin komunitat që kanë përfshirë përqindjen më të madhe të kërkesave të qytetarëve në buxhetet e tyre: në Ferizaj 80% e kërkesave janë përfshirë në buxhet, në Drenas 70% dhe në Dragash 78%. Përqindja më e ulët e kërkesave të pranuar është në Suharekë me vetëm 17%. Komunitat listojnë si arsye të refuzimit të kërkesave të qytetarëve kufizimet buxhetore, natyrën e vet kërkesave, që dijnë të jenë jashtë kompetencave të komunës, arsyet teknike, etj. Për shembull, ka raste kur nuk bëhet ndërtimi i objekteve të reja shëndetësore nga frika se ato objekte nuk mund të funksionalizohen për shkak të mungesës së stafit mjekësor.

Figura 35. Konsultimet buxhetore vlerësuar nga përfaqësimi gjinor



Nga 11 komunitat e fokusuar në këtë raport që kanë publikuar raportet e konsultimeve buxhetore me qytetarë, vetëm pesë nga to, Drenasi, Obiliqi, Rahoveci, Suhareka dhe Juniku i kanë paraqitur të dhënat e pjesëmarrësve sipas gjinisë. Në bazë të këtyre pesë komunave, vërehet një pjesëmarrje e kënaqshme e grave në konsultimet buxhetore, veçmas në Obiliq dhe Junik, por shqetësuese mbetet numri i vogël i pjesëmarrjes së përgjithshme të qytetarëve në këto konsultime.

Përfundime dhe rekomandime

Pavarësisht rritjes së konsiderueshme të investimeve kapitale dhe buxheteve përkatëse për investime në infrastrukturë, komunat po hasin vështirësi në përmbushjen e premtimeve zgjedhore që bien në fushën e infrastrukturës. Mangësi shtesë në këtë pikë rezulton mungesa në diversifikimin e investimeve përtej infrastrukturës bazike. Kjo situatë reflekton një mungesë fokusi në sektorë kyç si ekonomia, bujqësia apo urbanizimi, duke kufizuar potencialin kryesisht në infrastrukturë.

Gjithashtu, vërehet një tendencë në paraqitjen e buxheteve kapitale në mënyrë të përgjithësuar, pa specifikime të qarta për lokalitetet që do të përfitojnë. Kjo praktikë jo vetëm që redukton transparencën, por edhe krijon paqartësi në opinionin publik.

Në periudhën 2018–2023, 15 komunat e përfshira në këtë raport (Drenasi, Kaçaniku, Peja, Kamenica, Obiliqi, Graçanica, Suhareka, Rahoveci, Klina, Vitia, Dragashi, Juniku, Ferizaji, Podujeva dhe Prizreni) kanë pasur në dispozicion 566 milionë euro. Nga to, 13 komuna kanë paraqitur në buxhetet e tyre (përfshirë Junikun dhe Graçanicën) të dhënat për shpërndarjen e investimeve kapitale sipas lokaliteteve. Por, gjetjet tregojnë për një hendek të madh ndërmjet shpenzimeve kapitale që dedikohen në zonat urbane të qytetit dhe lokaliteteve rurale. Konkretisht, në periudhën 2018–2023, investimet kapitale në 13 komuna arritën vlerën totale prej 540 milionë euro, prej të cilave 98 milionë euro ose 18% u investuan në zona rurale dhe 442 milionë ose 82% mbesin në zonat/lagjet e qytetit.

Komunat e Kosovës kanë filluar të zbatojnë praktikën e konsultimeve publike për buxhet relativisht vonë, duke filluar nga viti 2019. Pandemia COVID-19 ka ndikuar negativisht në zhvillimin e konsultimeve publike gjatë viteve 2020–2021, duke kufizuar tubimet dhe funksionimin e ueb-faqeve komunale.

Komuna e Kamenicës shfaqet si më aktive me 29 dëgjime publike dhe 663 pjesëmarrës, duke pranuar 61% të propozimeve të qytetarëve në buxhet. Komunat e Dragashit, Drenasit dhe Ferizajt kanë përqindjen më të lartë të pranimit të kërkesave të qytetarëve në buxhet (78–80%), ndërsa Suhareka ka përqindjen më të ulët me vetëm 17%.

Vetëm 5 nga 11 komunat e analizuar kanë raportuar të dhëna të ndara sipas gjinisë për pjesëmarrjen në konsultime buxhetore. Pavarësisht pjesëmarrjes së kënaqshme të grave në disa komuna si Obiliq dhe Junik, mbetet shqetësuese pjesëmarrja e ulët e përgjithshme e qytetarëve në konsultimet buxhetore.

Nisur nga gjetjet e këtij raporti, Instituti GAP rekomandon:

Për komunat:

Komuna e Obiliqit, Vitisë dhe Kamenicës duhet të sigurohen që praktika e nisur me ndarjen e mjeteve nga investimet kapitale sipas lokaliteteve duhet të vazhdojë në të gjitha vitet pasuese.

Komuna e Junikut dhe Graçanicës duhet t'u përmbahen udhëzimeve që jep Ministria e Financave në qarkoren e parë buxhetore ku kërkohet që buxheti të jetë i detajuar, i qartë dhe i plotë, çka nënkupton që këto dy komuna duhet të nisin t'i ndajnë shumat e kapitaleve jo vetëm sipas projekteve, por edhe sipas lokaliteteve.

Komunat e përfshira në këtë analizë duhet të rrisin ndjeshëm shumën dhe përqindjen e mjeteve që i dedikojnë për investime kapitale nëpër lokalitetet rurale.

Komunat e përfshira në këtë analizë duhet të shikojnë lokalitetet që nuk kanë përfituar në gjashtë vitet e fundit nga fondet e kapitaleve që të përfshihen në projektet kapitale në vitet pasuese.

Komunat e përfshira në këtë analizë nevojitet të ndjekin një qasje më të balancuar në shpërndarjen e investimeve, duke mos u fokusuar vetëm në infrastrukturë por duke përfshirë më shumë investime në sektorët e ekonomisë, bujqësisë dhe urbanizimit.

Komunat duhet të organizojnë dëgjime me të shumta buxhetore, duke siguruar që qytetarët po informohen dhe po konsultohen lidhur me përmbajtjen e buxhetit. Njëherazi komunat duhet të shohin se cilat janë format më të mira që do t'i nxisnin qytetarët për të marrë pjesë në dëgjimet buxhetore.

Për Ministrinë e Financave:

Ministria e Financave duhet të sigurohet që komunat po i zbatojnë udhëzimet e saj të ofruara në qarkoren e parë buxhetore që hartimi i buxhetit të përmbajë ndarje të plotë, të qartë dhe të detajuar, që përfshin edhe specifikat e lokaliteteve dhe projekteve kapitale.



Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.

www.institutigap.org

Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr. 4, 10000 Prishtinë

Tel.: +383 38 609 339

info@institutigap.org

Ky projekt është mbështetur nga



**Co-funded by
the European Union**



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra



**Sweden
Sverige**

**Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC**

